



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok – Municipality of Istog

2017 – 2021

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E ISTOGUT

Istog Dhjetor, 2017

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E ISTOGUT 2017 - 2021

Partner implementues

INSTITUTI PËR
NDËRMARRËSI DHE
BIZNES TË VOGËL



INSTITUTE FOR
ENTREPRENEURSHIP
AND SMALL BUSINESS

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E ISTOGUT 2017 – 2021

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Istogut 2017 – 2021 është një dokument startegjik i cili është adaptuar nga Asambleja Komunale e Komunës së Istogut. Përgaditja dhe hartimi i kësaj startegjie është realizuar nga anëtarët e grupeve punuese për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal (ZHEL) nga Komuna e Istogut dhe ekspertët e Institutit për Ndërmarrësi dhe Biznes të Vogël (IESB).

Ekspertët nga Instituti për Ndërmarrësi dhe Biznes të Vogël-IESB

Prof. Dr. Besnik A. Krasniqi, udhëheqës i projektit, grupi Ekonomi
MSc. Saranda Lajqi, PhD cand, koordinatore e projektit
MSc. Rexhep Mehmeti, grupi Buxhet dhe Financa
MSc. Krenare Kaçiu, grupi Turizëm dhe Planifikim Hapsinor
MSc. Alban Krasniqi, grupi Shërbimet Publike, Shëndetësia dhe Politika Sociale
Fatlinda Hasani, grupi Infrastruktura dhe Shërbimet Publike
Burim Krasniqi, grupi Arsimi, Kultura, Rinia dhe Sporti

Konsulent i jashtëm

Dr. Skënder Kaçiu, grupi Bujqësia dhe Zhvillimi Rural,

Anëtarët e grupeve punuese për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal (ZHEL) nga Komuna e Istogut

Menaxher i Projektit: Jashar Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik

Grupi punues për ekonomi:

1. Imer Pajaziti udhëheqës i sektorit për ekonomi;
2. Arta Fetahu, zyrtare për planifikim, zhvillim dhe koordinim me donatorë;
3. Ilir Ferati, zyrtar i lartë për zhvillim të projekteve.

Grupi punues për buxhet dhe financa:

1. Hysni Maxharri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
2. Bajram Gerguri, udhëheqës i sektorit për buxhet dhe thesar;
3. Hatixhe Arifaj, menaxhere e Zyrës së Tatimit në Pronë.

Grupi punues për urbanizëm dhe planifikim hapësinor:

1. Isa Hoxha, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
2. Elfete Blakaj, përgjegjëse për mjedis;
3. Rustem Gashi, zyrtar për planifikim hapësinor dhe ndërtim.

Grupi punues për arsim, kulturë dhe veprimtari sportive:

1. Agim Haxhiu, drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë dhe Sport;
2. Bedri Hajzeraj, udhëheqës i sektorit për kulturë, rini dhe sport;
3. Qefserë Ibrahimaj, përgjegjëse për mjedis.

Grupi punues për zhvillim rural:

1. Beqir Metaj, u.d., i drejtorit për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi;
2. Bedri Hasnaj, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;
3. Rasim Mahmutovic, udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Përmbajtja

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës	10
1. Hyrje	11
2. Përmbledhje ekzekutive	12
3. Korniza institucionale dhe qeverisja demokratike	13
4. Ekonomia	16
5. Organizimi i shërbimeve publike	28
6. Infrastruktura lokale dhe qëndrueshmëria urbane	33
7. Arsimi, kultura, rinia dhe sporti	34
8. Shëndeti publik dhe mirëqenia sociale	36
9. Sistemi i menaxhimit të performancës dhe realizimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal	37
10. Vizioni, Misioni dhe Vlerat	40
11. Synimet dhe objektivat	40
12. Projektet për arritjen e synimeve dhe objektivave	43
Shtojca I: Harta e Komunës së Istogut	67

Shkurtesat

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
b.	Banorë
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
DPUN	Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ha	Hektar
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KASH	Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KK	Kuvendi i Komunës
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjetësimit,
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PPP	Partneritet Publiko-Privat
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
UNDP	United Nations Development Program

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës

Të dashur istogas,

Komuna e Istogut është komunë e cila është e njohur për qeverisje efikase, efektive, transparente dhe llogaridhënëse që ofron shërbime cilësore për qytetarët e saj, në shërbime administrative, infrastrukturë, bujqësi, arsim, shëndetësi, kulturë, rini, sport dhe mirëqenie sociale. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e komunës së Istogut është një dokument i rëndësishëm që siguron qasje të plotë në kapacitetet ekzistuese të komunës dhe njëherit, ofron analizë profesionale dhe projekte të mundësive zhvillimore dhe inovative. Përmes kësaj strategjie synohet pjesëmarrje aktive e grupeve të interesit, shoqërisë civile, OJQ-ve, bizneseve dhe përfaqësimit demokratik të ofrohen shërbime me kosto efektive dhe të përgjegjshme për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë lokale.

Rëndësia e kësaj strategjie është që të bëjë të arritshëm visionin e Istogut me zhvillim ekonomik lokal të qëndrueshëm, infrastrukturë moderne dhe shërbime publike efikase dhe cilësore, i integruar në proceset rajonale, i gjelbëruar dhe i pastër, me trashëgimi natyrore dhe kulturore, qendër e turizmit, kulturës, sportit dhe arsimit cilësor, me shërbime shëndetësore adekuate.



Kjo Strategji për Zhvillimin Ekonomik lokal për vitet 2017-2021, në bashkëpunim me ju dhe me grupet e tjera të interesit, do të hap mundësi të reja, për sigurimin e fondeve për projekte që dalin nga visioni dhe objektivat e komunës së Istogut.

Qytetarë të nderuar, të punojmë bashkarisht për një Istog modern dhe të zhvilluar. Ju e keni fuqinë tuaj në vendimarrje, me qëllim që të ndërtojmë së bashku një të ardhme me prespektive për ju dhe gjeneratat pas nesh.

*Përzemërsisht,
Kryetari i Komunës së Istogut
z.Haki Rugova*

1. Hyrje

Në këtë dokument strategjik komuna e Istogut ofron vizionin, përcakton synimet, objektivat strategjike, për ta bërë vizionin e Istogut realitet, një mjedis tërheqës për të gjithë. Ky dokument është hartuar si rezultat i një konsultimi gjithëpërfshirës, me baza të gjëra, duke përfshirë këtu mobilizimin politik të kryetarit të komunës, stafit komunal, ekipit të ekspertëve, shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe komunitetit të biznesit. Prandaj, si i tillë, përbën një përpjekje dhe obligim të përbashkët për ta jetësuar vizionin për një Istog me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, infrastrukturë moderne dhe shërbime publike efektive dhe cilësore, i integruar në proceset rajonale, i gjelbëruar dhe i pastër, me trashëgimi kulturore, qendër e turizmit, kulturës, sportit dhe arsimit cilësor, me shërbime shëndetësore adekuate.

Istogu, sikurse edhe komunat e tjera, është ballafaquar me pasojat e luftës së fundit dhe sfidat rindërtimit infrastrukturor, ekonomik e bujqësor. Përkundër këtyre sfidave, kjo strategji paraqet një hap të rëndësishëm drejt realizimit të vizionit për Istogun. Ajo ofron zgjidhje praktike për shumë probleme aktuale dhe mundëson pozicion konkurrues të Istogut në raport me komunat e tjera në Kosovë dhe sidomos në Rajonin e Dukagjinit. Konform këtij pozicioni konkurrues dhe kufizimeve buxhetore janë përcaktuar synimet dhe objektivat për periudhën 2017-2021. Po ashtu janë përcaktuar edhe fushat e përbashkëta ku mund të bashkëpunojë komuna e Istogut me komunat e tjera, si Peja dhe komunat kufitare lidhur me zhvillimin dhe shfrytëzimin e mundësive turistike.

Procesi i hartimit të strategjisë ka qenë një proces gjithëpërfshirës me përfaqësues të të gjitha palëve të interesit, me vëmendje specifike në komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, komunitetet, grupet sociale etj. Të gjitha aktivitetet për përgatitjen e kësaj strategjie janë koordinuar nga Këshilli Drejtues i Strategjisë, ku kanë marrë pjesë udhëheqësit më të lartë të komunës dhe drejtorët e departamenteve, përfaqësuesit e biznesit dhe të shoqërisë civile. Gjatë procesit të hartimit të strategjisë janë themeluar 5 grupe punuese me

nga së paku 3 anëtarë. Në secilin grup, së paku 3 anëtarë kanë qenë nga drejtoria përkatëse në komunë dhe 2 nga komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile. Instituti "IESB" në këtë proces ka mbështetur grupet punuese përmes ofrimit të ekspertizës së tij në hartimin e strategjisë dhe çështje të zhvillimit lokal, si dhe ka ofruar trajnimin e zyrtarëve komunalë në hartimin dhe zbatimin e projekteve. Për këtë qëllim, Instituti "IESB" ka angazhuar ekspertë vendorë dhe ka organizuar 2 punëtori dhe dhjetëra takime pune me palët e interesit, si dhe me anëtarët e ekipit të strategjisë. Stafi komunal është trajnuar lidhur me hartimin e strategjisë dhe menaxhimin e projekteve. Gjatë këtyre punëtorive është bërë agregimi i rezultateve të grupeve individuale dhe janë diskutuar në grupe më të gjëra si tërësi. Pas përpilimit të draftit të parë, është zhvilluar një konsultim intensiv me grupet e interesit dhe janë marrë në konsideratë sugjerimet e tyre.

Ky dokument është organizuar në këtë mënyrë. Kapitulli dytë jep një pasqyrë përmbledhëse të përshkrimit të gjendjes, vizionit dhe synimeve të strategjisë zhvillimore. Në kapitullin e tretë jepet një pasqyrë e kornizës institucionale dhe qeverisjes demokratike. Në kapitullin katërt pasqyrohet gjendja në ekonominë lokale dhe zhvillimin rural. Në kapitullin pestë paraqitet gjendja e shërbimeve publike. Në kapitullin e gjashtë pasqyrohet infrastruktura lokale. Në Kapitullin shtatë prezantohet arsimit, kultura, rinia dhe sporti. Në kapitullin e tetë paraqitet gjendja shëndetësive dhe mirëqenia sociale. Në kapitullin e nëntë diskutohet sistemi i menaxhimit të performancës dhe realizimit të startegjisë. Kapitulli dhjetë ofron vizionin dhe misionin për komunën e Istogut, ndërsa Kapitulli njëmbëdhjetë përcakton synimet dhe objektivat. Në kapitullin e dymbëdhjetë jepet amza e projekteve dhe ndërlidhja e tyre me objektivat dhe synimet e strategjisë.

2. Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Istogut ka një buxhet prej 9,212,022 € (sa është parashikuar në vitin 2017) dhe është shumë e vështirë të mbulohen të gjitha nevojat për investime kapitale. Burimi kryesor i të hyrave të komunës është granti qeveritar, që përbën mbi 84,1 % të të hyrave të komunës dhe pjesa tjetër vjen nga të hyrat vetjake dhe një pjesë e vogël nga donacionet e brendshme. Sipas të dhënave komunale, në Istog janë rreth 2605 (deri më 05.12.2016) biznese të regjistruara, edhe pse ekonomia kryesisht bazohet në bujqësi me rreth 60 % të qytetarëve të angazhuar në këtë sektor.

Megjithëse janë bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe shërbime publike, situata është ende e pakënaqshme në fushën e zhvillimit të turizmit, sidomos në raport me vizionin e komunës së Istogut. Ka ende nevojë për shumë infrastrukturë rrugore dhe ndërtim të rrugëve të reja (sidomos shtigjeve për ecje), ndërtim dhe modernizim të rrjetit të kanalizimit, rritje të konsiderueshme të kapacitetit të furnizimit me ujë për qytetarët etj. Sfidë e veçantë mbetet ende trajtimi i ujërave të zeza dhe prerja e pyjeve pa plan.

Komuna e Istogut ka shënuar një përparim të dukshëm në ngritjen e infrastrukturës për jetë cilësore dhe për zhvillim të aktiviteteve ekonomike bujqësore dhe jobujqësore në këto zona. Edhe pse ka kapacitete për zhvillimin e shumë aktiviteteve, prodhimtaria bujqësore dhe sidomos turizmi rural mund të promovohen edhe më shumë, për të jetësuar vizionin për Istogun e pastër dhe atraktiv për ta vizituar.

Për të përballuar më me sukses sfidat për zhvillimin e komunës dhe për të krijuar një ambient më miqësor e më atraktiv për zhvillimin e bizneseve dhe ngritjen e cilësisë së jetesës për banorët e saj, komuna e Istogut ka përgatitur këtë dokument: "Strategjia zhvillimore lokale e komunës së Istogut 2017-2021". Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është që, pas identifikimit të gjendjes, përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve për komunën e Istogut, të propozojë vizionin dhe të identifikojë

synimet, objektivat dhe projektet konkrete që do të promovojnë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të bëjë një hap të madh drejt jetësimin të vizionit të komunës së Istogut.

Pas shumë debateve, konsultimeve dhe analizave përfshirë këtu edhe analizën e dokumenteve strategjike kyçe dhe planet dhe dokumentet strategjike ekzistuese të komunës (Plani i Zhvillimit Ekonomik Lokal, Plani i Transportit Lokal, Plani Zhvillimor Komunal, Plani Zhvillimor Urbanistik, Plani Rregullues Urbanistik, Plani i ndërtimit dhe rindërtimit të rrugëve lokale, Strategjia e Zhvillimit Rural dhe Turizmit etj.), Komuna e Istogut ka përvetësuar këtë vizion për zhvillimin e saj të qëndrueshëm dhe të balancuar ekonomik dhe shoqëror: *Istogu, me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, infrastrukturë moderne dhe shërbime publike efikase dhe cilësore, i integruar në proceset rajonale, i gjelbëruar, i pastër, me pasuri natyrore dhe trashëgimi kulturore, qendër e turizmit, kulturës, sportit, arsimit dhe me shërbime shëndetësore cilësore.*

Bazuar në këtë vizion dhe në problemet dhe mundësitë që ka komuna e Istogut, ekipi i strategjisë ka identifikuar 6 synime strategjike, të cilat ngërthejnë ë në vete 34 objektiva strategjike. Këto synime dhe objektiva kontribuojnë drejtpërdrejt në vizionin i cili ka një konsensus të gjerë. Synimet janë:

Synimi 1. Krijimi i një mjedisi më të favorshëm për zhvillim të bizneseve dhe tërheqës për investitorë

Synimi 2. Bujqësi të zhvilluar me prodhimtari intensive

Synimi 3. Avancimi i infrastrukturës turistike, mjedisit dhe resurseve

Synimi 4. Shërbime publike dhe infrastrukturë cilësore

Synim 5. Sigurimi i kapaciteteve funksionale infrastrukturore fizike dhe promovimi i aktiviteteve rinore, kulturore dhe arsimore

Synimi 6. Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirëqenies sociale

Janë identifikuar 291 projekte specifike, që sigurojnë arritjen e synimeve dhe objektivave me një kosto së përgjithshme të implementimit të strategjisë prej 54,717,776 €. Megjithatë, kjo listë e projekteve nuk është përfundimtare, pasi që asaj mund t'i shtohen edhe projekte të tjera që mund të identifikohen në vazhdimësi. Për secilin projekt janë identifikuar burimet e mundshme të financimit dhe partnerët implementues të mundshëm dhe afati i realizimit nga momenti i fillimit të projektit. Ekipi i strategjisë, po ashtu, ka identifikuar projekte që potencialisht mund të realizohen me koncesion ose përmes partneritetit publik privat.

3. Korniza institucionale dhe qeverisja demokratike

Komuna e Istogut, për nga madhësia është komunë mesatare në Republikën e Kosovës. Gjatë këtij mandati qeverisës, udhëheqja komunale e ka bërë ridizajnimin esencial në strukturën organizative, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore dhe më të shpejta për qytetarët dhe bizneset. Së këndejmi, brenda drejtorive janë formuar një numër i caktuar i sektorëve për fusha të caktuara, në mënyrë që të përmirësohet funksionalizimi dhe menaxhimi më i mirë i tyre. Struktura organizative është paraqitur në Figurën 3.1. Funksionalizimi i kësaj strukture administrative është bërë i mundur edhe me ndërtimin e objektit të ri të komunës, me të cilin janë krijuar kushte shumë të mira për qytetarët dhe hapësirë e mjaftueshme

punuese për personelin e administratës komunale. Kuvendi i Komunës është organ legjislativ i komunës, i cili ushtron funksionet bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040/2008, dhe statutin e komunës nr.01nr.62/2010. Kuvendi Komunal është i përbërë nga 27 anëtarë. Administrata komunale është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha detyrave ekzekutive të caktuara me ligje, statut dhe me akte të tjera nënligjore. Komuna e Istogut kryen shërbime të ndryshme dhe të shumta për qytetarë, duke filluar nga rregullimi i dokumenteve të statusit civil deri në planifikimin dhe zbatimin e projekteve kapitale me interes të përgjithshëm.




Figura 3.1: Struktura organizative e Komunës (Organogrami)

Komuna e Istogut në përgjithësi nuk ka pasur ndonjë rritje të theksuar të popullsisë, me përjashtim të qytetit të Istogut, që ka pasur një rritje të popullsisë që nga periudha e pasluftës, kryesisht përmes migrimit të popullatës nga viset rurale të komunës. Gjatë tërë periudhës së pasluftës, strukturat qeverisëse dhe po ashtu organizatat e huaja dhe donatorët janë përpjekur që Istogut t'i japin një shtytje, sidomos në fushën e administratës, bujqësisë dhe turizmit, duke arritur rezultate konkrete në zhvillimin institucional dhe ekonomik të komunës. Në aspektin organizativ dhe funksional, komuna e Istogut ka 50 fshatra dhe 5 vendbanime urbane.

Kuvendi i komunës e ka harmonizuar statutin e komunës dhe rregulloret përkatëse me rregullativën ligjore në fuqi. Me statut dhe rregullore komunale janë krijuar mekanizma që shoqëria civile, shoqatat e biznesit dhe qytetarët dhe akterët e tjerë të interesuar të ushtrojnë ndikimin e tyre në vendimet që merren në Kuvendin Komunal dhe në nivelet e tjera të qeverisjes komunale. Asnjë

dokument i rëndësishëm i komunës, siç janë Plani Zhvillimor (duke përfshirë edhe këtë strategji), planet rregullative, rregulloret mbi taksat dhe ngarkesat administrative, nuk merret pa diskutim paraprak publik dhe marrjen e opinionëve të qytetarëve dhe të gjithë akterëve të interesuar. Kjo siguron një përfshirje të gjerë të të gjitha palëve të interesit në marrjen e vendimeve strategjike të komunës.

Historiku i shkurtër i komunës

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Në veriperëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në verilindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jugperëndim me komunën e Pejës. Ka sipërfaqe prej 453.84 km². Qendër komunale është qyteti i Istogut. Istogu ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, i hapur në të gjitha anët, me përjashtim të pjesës veriore, e cila është e rrethuar me male të larta, me lartësi mbidetare përtej 2.000

metrave. Me një infrastrukturë të mirë rrugore, që i mundëson komunikim të mirë me trevat e tjera të Kosovës.

Ky territor, në aspektin gjeografik dhe etno-kulturor, njihet si Podgur. Si nocion, Podguri është një nënkrahinë etnografike që zë pozitën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Kufizimi gjeografik i Podgurit fillon me burimin e lumit Drini i Bardhë, ngjitet në majën e Rusolisë, vazhdon me masivin e maleve të Moknës, ndërsa kufiri lindor e juglindor është lumi Gujavç. Takimi i lumit Gujavç me lumin Istogu dhe me Drinin e Bardhë e përmbyll gjeografikisht trevën e Podgurit. Popullata autoktone e ka emërtuar “Pod i gurit” shkëmbin i cili i detyron tri burimet e ujit, Istogun, Vrellën dhe Drinin e Bardhë, të shpërthejnë në të njëjtën lartësi mbidetare. Istogu gjendet në qendër të Podgurit.

Pozita gjeografike, klima, pasuritë natyrore, kanë kushtëzuar që Istogu të jetë i banuar që nga lashtësia. Ai ishte pjesë integrale e hapësirës ilire shqiptare. Në territorin e komunës së Istogut janë gjetur gjurmë vendbanimesh që datojnë edhe nga parahistoria. Istogu është i pasur po ashtu me vlera emblematike të trashëgimisë së kulturës materiale dhe shpirtërore.

Rrethi i Istogut në kuptimin e sotëm administrativ është formuar më 1913, pas pushtimit të Kosovës nga ana e ushtrive serbo-malazeze. Istogu si qendër e rrethit ka funksionuar prej vitit 1912 deri në vitin 1947. Më 1947 qendra u transferua në Gjurakoc. Më 1 janar të vitit 1960 u bë edhe një riorganizim i organeve lokale të pushtetit, kështu që në tërë territorin e Kosovës u suprimuan të gjitha rrethet. Pas suprimimit, u bashkuan komunat Istog e Gjurakoc, me qendër në Istog, për të formuar njësinë e administrimit lokal ashtu si funksionon edhe sot. Me shtimin e përmbajtjeve administrative, arsimore e kulturore, Istogu në dhjetor 1978 shpallet qytet.

Struktura e popullsisë

Komuna e Istogut, sipas regjistrimit të fundit (viti 2011) të bërë nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, ka strukturë të popullsisë të paraqitur në Tabelën 1. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë 29.3 % jetojnë në qytet, kurse pjesa dërmuese jeton në viset rurale.

Zona e banuar	Banorë	Meshkuj	Femra	Nr. i objekteve	Nr. i banesave	Nr. i objekteve të pabanuara	Nr. i ekonomive familjare
Zona urbane	11,316	5,675	5,641	-	-	-	-
Zona rurale	27,355	13,695	13660	-	-	-	-
Komuna e Istogut	38,671	19,370	19,301	8,971	9,651	2,929	6,778

Tabela 3.1. Komunitetet që jetojnë në komunën e Istogut

Në bazë të të dhënave më të fundit, komuna e Istogut ka rreth 39.621 banorë, ku shumica janë shqiptarë, 1650 i përkatësisë nacionalitetit boshnjak, 2260 janë të nacionalitetit egjiptian dhe rom, ndërsa rreth 800 të nacionalitetit serb. Në territor të komunës, sipas regjistrimit të fundit, janë 6582 ekonomi familjare. Komuna e Istogut përfshin 50 vendbanime urbane dhe rurale dhe 9651 banesa. Sipas numrit të banorëve, i kemi katër lloje të vendbanimeve në komunën e Istogut:

Në kategorinë e parë prej 0-300 banorë, në komunën e Istogut, sipas statistikave, janë 12 vendbanime. Në këtë kategori në pjesën perëndimore janë të vendosura 12 fshatra: Bellopoja, Belica, Dubova e Vogël, Llukavci i Thatë, Mojtiri, Osojani, Polana, Sineja, Shalinovica, Koshi, Tuqepi, Veriqi i Ri.

Në kategorinë e vendbanimeve të mesme 300-2000 banorë, në komunën e Istogut i kemi 29 fshatra: Banjica, Caralluka, Dobrusha, Dragoleci, Dreja, Dubova, Llukavci i Begut, Muzhevina, Orrobërda, Prekalla, Pigoda, Serbobrani, Staradrani, Sudenica, Syrigana, Kalijani, Kashica, Kerrnina, Lubova, Lubozhda, Llugat, Shushica, Tomoci, Trubuhoci, Uça, Veriqi, Zabllaqi, Zallqi, Zhakova.

Në kategorinë e tretë prej 2000-3000 banorë, hyjnë vendbanimet e mëdha rurale, siç janë Istogu i Poshtëm, Rakoshi, Cerrca dhe Kovraga.

Në kategorinë e vendbanimeve më të mëdha se 3000 banorë hyn Istogu, si qendër kryesore e të gjitha vendbanimeve përreth. Vendbanimi i Istogut është i vendosur në pjesën veriore të komunës, si dhe Gjukurkoci, Banja dhe Vrella, si qendra urban.

4. Ekonomia

Buxheti: burimet e të hyrave dhe shfrytëzimi i tyre

Gjatë vitit 2015, komuna e Istogut ka pasur të hyra prej rreth 9,212,022 € (Tabela 4.1). Në tabelë janë paraqitur burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike, si dhe të hyrat e arkëtuara. Burimi kryesor i të hyrave të komunës është granti

qeveritar që përbën mbi 84,1 % të të hyrave të hyrave të komunës. Pjesa tjetër vjen nga të hyrat vetjake dhe një pjesë e vogël nga donacionet e brendshme. Nga të hyrat vetjake, pjesën më të madhe e përbëjnë Drejtoria për Urbanizëm Kadashtër dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe nga tatimi në pronë. Të dyja këto kategori të të hyrave vetjake kanë shënuar një rritje të rëndësishme (të hyrat nga lejet e ndërtimit afërsisht janë dyfishuar).

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final*	2015 Shpenzimet	2014 Shpenzimet
Burimet e Fondeve:	8,578,023	9,212,022	8,878,415	8,176,752
Granti i Qeverisë - Buxheti	7,563,874	7,747,241	7,711,699	7,420,977
Të bartura nga viti paraprak ²	-	411,741	391,906	106,245
Të hyrat vetjake	1,014,149	1,014,149	742,835	606,985
Donacionet e brendshme	-	38,891	31,975	24,465
Donacionet e jashtme	-	-	0	18,080

Tabela 4.1: Të hyrat e përgjithshme të komunës së Istogut – buxheti dhe shpenzimet (në €)

Burimi: Të dhënat komunale, 2016

*Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 633,999 €.

Kjo rritje është rezultat i vendimit të qeverisë për pagesën e përvojës së punës në shumë 183,367 €, për të hyrat e bartura me vlerë prej 411,741€, si dhe donacioneve të brendshme me vlerë 38,891 €.

Tabela 4.2 në vijim paraqet të hyrat vetjake të planifikuara për periudhën 2017-2019. Kjo tabelë jep informacione se ekziston një trend i zvogëluar i

të hyrave vetjake të planifikuara, gjë që përputhet me aktivitete ekonomike stabile të Istogut gjatë viteve të fundit.

Vitet	Përshkrimi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total	Ndryshimi (%)
2017	TOTAL SHPENZIMET	5,799,714	853,700	117,000	223,813	2,362,979	9,357,206	
	Grantet qeveritare	5,760,714	701,500	117,000	-	1,551,297	8,130,511	
	Të hyrat vetjake	39,000	152,200	-	223,813	811,682	1,226,695	
	Financimi i jashtëm	-	-	-	-	5,737,745	5,737,745	
2018	TOTAL SHPENZIMET	6,069,408	805,920	177,538	251,750	2,560,934	9,852,550	5.293717
	Grantet qeveritare	6,030,408	691,700	177,538	-	1,808,000	7,721,957	-5.02495
	Të hyrat vetjake	39,000	114,220	-	251,750	752,934	1,157,904	-5.60783
	Financimi i jashtëm	-	-	-	-	2,210,000	2,210,000	-61.4831
2019	TOTAL SHPENZIMET	6,050,796	805,920	177,538	251,750	2,726,119	10,016,123	1.66021
	Grantet qeveritare	5,983,796	691,700	177,538	-	1,840,119	7,783,864	0.801701
	Të hyrat vetjake	25,000	114,220	-	251,750	886,000	1,276,970	10.28289
	Financimi i jashtëm	-	-	-	-	5,055,000	5,055,000	128.733

Tabela 4.2.: Shpenzimet komunale 2017-2019

Burimi: Komuna e Istogut, 2016

Korniza fiskale komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon (shih Tabelën 4.3). Korniza Afatmesme Buxhetore e komunës është në përputhje me Kornizën Makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2016-2018, të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike, siç janë Bruto Produkti Vendor (BPV-GDP), inflacioni dhe demografia, duhet konsideruar dhe duhet marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016-2018 e Qeverisë së Kosovës, bazuar në të dhënat historike, si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecure pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2016-2017, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vëndit në 2016 dhe 2018 parashihet të jetë 3 % për çdo vit.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale. Aktualisht financimi komunal përfshin: të hyrat vetanake dhe grantet Qeveritare. Komuna në periudhën afatmesme buxhetore 2016-2018 planifikon të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie dhe Ligji për Huamarrje.

Indikatorët ekonomikë komunalë	2015	2016	2017	2018 (vlerësim)*
Popullsia e komunës	44,000	44,000	44,000	44,000
Numri i bizneseve të regjistruara	2,084	2,605	2,2750	2.910
Numri i nxënësve	9,370	9,270	9,552	-

Tabela 4.3: Indikatorët ekonomikë komunalë

Burimi: Komuna e Istogut, 2016

*Vlerësimi bazuar në mesataren e regjistrimit të bizneseve të reja (150 në vit)

Në Tabelën 4.4. në vijim është bërë një prezantim më përmbajtjesor i strukturës së të hyrave vetanake të komunës për vitin 2014-2019, që në vitin e fundit arrin vlerën 1,226,695 €. Kjo tabelë është e bazuar në KAB, që është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Kuvendi Komunal (KK). Komuna e Istogut në vitin e kaluar ka pasur të përgatitur dokumentin e KAB-it komunal, ku do të përfshiheshin vlerësimet e hershme të të ardhurave buxhetore totale dhe shpenzimeve dhe paraqitjen e tyre sipas programeve-drejtorive, nënprogrameve buxhetore dhe kategorive ekono-

mike për tri vite. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB siguron mekanizmat e nevojshëm, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe për identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve financiare komunale për periudhën 2016-2018.

Komuna e Istogut	Grantet dhe THVK -2015	Grantet dhe THVK -2015	Grantet dhe THVK -2015	Grantet dhe THVK -2015	Grantet dhe THVK -2015
Taksa për certifikatat e lindjes	40,800.00	39,000.00	39,500.00	39,500.00	39,500.00
Taksa për certifikatat e kurorëzimit	11,000.00	9,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Taksat për certifikatat e vdekjes	1,150.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Taksa për certifikata të tjera të ofiqarisë	17,300.00	16,000.00	17,000.00	17,000.00	17,000.00
Taksa për verifikim të dokumentacionit të ndryshëm	3,100.00	2,000.00	3,000.00	3,000.00	3,000.00
Taksa administrative për fletëkërkesë	1,620.00	1,100.00	1,200.00	1,200.00	1,200.00
Taksa për pjesëmarrje në tender	2,700.00	0	-	-	-
Shitja e mallrave	2500	3500	3,600.00	3,600.00	3,600.00
Dënimet e regjistrimit me vonesë	7,500.00	3,000.00	3,500.00	3,500.00	3,500.00
Regjistrimi i martesave dhe lindjeve që ndodhin jashtë R. së Kosovës	4,000.00	1,000.00	1,500.00	1,500.00	1,500.00
TOTAL DREJTORIA PËR ADMINISTRATË DHE PERSONEL	91,670.00	75,600.00	80,300.00	80,300.00	80,300.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	107,000.00	135,000.00	160,500.00	160,500.00	160,500.00
Ndërrimi dhe destinimi i tokës					
Taksa për demolim					
Shfrytëzimi i pronës publike	8,700.00	9,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
Inspektimi i aktiv. në terren, që bëjnë matjen e vendit	62,000.00	63,000.00	85,000.00	85,000.00	85,000.00
TOTAL DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	177,700.00	207,000.00	265,500.00	265,500.00	265,500.00
Tatimi në pronë	295,009.00	349,549.00	397,000.00	397,000.00	397,000.00
Taksa administrative për fletëkërkesë	3,700.00	2,800.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Qiraja nga objektet publike	32,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Taksa për regjistrimin e automjeteve	63,000.00	64,000.00	73,000.00	73,000.00	73,000.00
TOTAL DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	393,709.00	426,349.00	484,000.00	484,000.00	484,000.00
Licenca për shitje në rrugë, kioske & shërbim					
Licencë për shërbime profesionale					
Licencë për lojëra					
Licencë për dyqane të mëdha					
Licencë për shitje me pakicë, naftë dhe derivate					
Shërbime të pijeve alkoolike					
Licencë për objekte hoteliere					
Licenca të tjera për afarizëm					
Licenca aktive individuale të lira					
Ngarkesa vjetore për afarizëm (buxhet e viteve 2005-2012)	6500	15000	-	0.00	0.00
Ngarkesa vjetore për lejimin e përdorimit të pijeve alkoolike	1500	3000	3,500.00	3,500.00	3,500.00
Ngarkesa vjetore për zgjatjen e orarit të punës për subjekte afariste	650	750	500.00	500.00	500.00

TOTAL DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM	8,650.00	18,750.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Licenca të tjera për afarizëm					
Ndërrimi dhe destinimi i tokës bujqësore			20,000.00	20000	20000
Inspektimi veterinar brenda vendit					
Taksa për dhënien e lejeve për prerje të pyjeve private	1,350.00	1,350.00	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Qiraja për toka bujqësore në pronësi të komunës	32,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
TOTAL DREJTORIA PËR BUJQËSI, HIDROEKONOMI DHE PYLLTARI	33,350.00	21,350.00	41,500.00	41,500.00	41,500.00
Participimi nga arsimi parafillor – çerdhet	84,920.00	85,000.00	99,895.00	99,895.00	99,895.00
Participimi nga arsimi fillor	720	720	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Participimi nga arsimi i mesëm	17,200.00	10,000.00	25,000.00	25,000.00	25,000.00
Qiraja nga objektet publike	2,100.00	2,200.00	3,000.00	3,000.00	3,000.00
TOTAL DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT	104,940.00	97,920.00	128,895.00	128,895.00	128,895.00
Shitja e mallrave	300	300	500.00	500	500
Taksa administrative për fletëkërkesë	500	500	300.00	300	300
Dhënia e certifikatave për ekshumimin e kufomave	200	200	200.00	200	200
Certifikata që nuk i është hequr zotësia, certifikata për shlyerje dhe marrje të nënshetësisë	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2000	2000
Participimi nga shëndetësia	45,000.00	45,000.00	55,000.00	55,000.00	55,000.00
TOTAL DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	48,000.00	48,000.00	58,000.00	58,000.00	58,000.00
Leje të tjera për afarizëm-taksi dhe autobus	3,300.00	3,400.00	3,500.00	3,500.00	3,500.00
Leje për dëmtim të infrastrukturës	4,000.00	4,800.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
	4,000.00	3,831.00			
TOTAL DREJTORIA PER SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM	11,300.00	12,031.00	5,500.00	5,500.00	5,500.00
TOTAL DREJTORIA E INSPEKTORATIT			5,500.00	5,500.00	5,500.00
TË HYRAT NË FB. fondi 21	869,319.00	907,000.00	1,072,695.00	1,072,695.00	1,072,695.00
Gjjobat e trafikut (Policia)	32,000.00	28,000.00	44,000.00	44,000.00	44,000.00
Agjencia e Pyjeve e Kosovës	26,000.00	10,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00
Gjjobat e trafikut (Gjykatat)	86,830.00	75,000.00	95,000.00	95,000.00	95,000.00
DONACIONET (FONDI 67)					
DONACIONET (FONDI 41)					
TOTAL PLANIFIKIMIT I TË HV	1,014,149.00	1,020,000.00	1,226,695.00	1,226,695.00	1,226,695.00

Tabela 4.4: Korniza Afatmesme Buxhetore, Komuna e Istogut

Burimi: Komuna e Istogut, 2016

Komuna e Istogut e përdor një sistem të balansit të lirë (free balance) të kontabilitetit dhe posedon shënime të gjenerimit të shifrave të mira me të hyrat vetjake. Qeveria e Kosovës ka hyrë në Programin e ri të Monitorimit të Stafit me FMN. Kjo marrëveshje ka kërkesa të cilat u adresohen të gjitha komunave dhe ato janë: një limit i maksimumit të shpenzimeve në rroga dhe mëditje dhe një limit në numrin total të stafit ekuivalent me orar të plotë. Mbledhja e të hyrave vetjake përdoret ekskluzivisht për projekte kapitale të rëndësisë së

veçantë për qytetarët në komunë. Të hyrat janë të mbledhshme me lejet e ndërtimeve, por kjo nuk mjafton për t'i mbuluar shpenzimet e infrastrukturës publike, veçanërisht në lagjet jourbane. Komuna u vë taksa qytetarëve për disa shërbime, por kjo kosto vetëm mbulon koston e shërbimeve. Sa i përket shërbimeve ndaj qytetarëve e ekziston një program i qartë për zhvillimin e shkathtësive dhe mësimin të stafit dhe i tërë stafi vlerësohet në performancën e vet gjatë tërë vitit, gjë që përfshin një vlerësim vjetor zyrtar të performancës.

Bizneset dhe rrethina e biznesit

Istogu zhvillimin ekonomik e ndërlihd edhe me fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe industrinë dhe bizneset. Meqenëse në komunën e Istogut nuk ka një zhvillim të mirëfillt ekonomik, si dhe industri dhe bujqësi të zhvilluar, mund të thuhet se tregtia është degë parësore në ekonominë e kësaj komune. Mirëpo, në këtë mes kryesisht importohet malli, nga komunat fqinje dhe nga shtetet fqinje, çka do të thotë se tregtia e brendshme është e theksuar më shumë në krahasim me tregtinë e jashtme. Andaj, tregtia vazhdon të jetë forma më e përhapur e koncentrimin të kapitalit në sektorin privat.

Fokusi i ndërmarrjeve lokale duhet të orientohet në prodhimtarinë bujqësore dhe në shërbime. Përveç prodhimit edhe përpunimit dhe përsosja e produkteve ushqimore janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e kësaj industrie. Për prodhimin e produkteve kualitative është e nevojshme fuqi punëtore e aftë, prandaj trajnimet dhe kurset profesionale janë ato që duhet ta plotësojnë prodhimtarinë bujqësore dhe përpunimin e produkteve ushqimore.

Për shkak se shumica e territorit në këtë zonë është rrafshinore, arat e mbjella me drithëra dhe pemë dhe perime duhet të mbrohen dhe të zgjerohen. Industrinë dhe bizneset të cilat i përpunojnë resurset rajonale, duhet të gjejnë përkrahje në agjencinë rajonale për marrëveshje, që është përgjegjëse për hulumtim profesional të loka-

cioneve, si dhe menaxhim të tyre. Në kuadër të zonave të krijuara biznesore dhe industriale, duhet të sigurohet infrastruktura dhe lidhjet efikase me rrjetin regjional rrugor. Hapësira e parkut komunal të biznesit duhet të pajiset me furnizim vetjak të energjisë, e bazuar në format e përsëritshme të energjive rajonale. Kjo siguron furnizim të përhershëm me energji për ndërmarrjet. Profesionistët e rinj duhet të trajnohen për zhvillim ekonomik dhe marketing, me anë të seminareve dhe kurseve në shkollat profesionale.

Në sferen e zhvillimit ekonomik, në Istog është e zhvilluar bujqësia përfshirë drithërat, pemët, perimet dhe prodhimet e mishit. Istogu njihet shumë për fermën e peshkut troftë, e cila ishte privatizuar në vitin 2004 dhe është një shembull i suksesshëm i procesit të privatizimit. Papunësia është e lartë dhe bizneset, përfshirë dyqanet, kafiteritë dhe restorantet, janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Përkundër këtyre shifrave, administrata publike mbetet punëdhënësi kryesor.

Sipas të dhënave komunale, në Istog janë rreth 2604 biznese të regjistruara. Ekonomia kryesisht bazohet në bujqësi me rreth 60 % të qytetarëve të angazhuar në këtë sektor (Para konfliktit të vitit 1999, 80 %). Prodhimet bujqësore prodhohen në kuadër të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ku komuna do t'u ofrojë mbështetje dhe hapësira për zhvillimin e veprimtarisë, në mënyrë që të mundësohet një prodhimtari efikase. Përveç bujqësisë sektor tjerë të zhvilluar janë tregtia, blegtoaria dhe ndërtimi (shih Tabelën 4.5)

Përshkrimi	Nr i Bizneseve	Përqindja
Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani	301	11.56
Aktiviteti i taksive	218	8.37
Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore	132	5.07
Rritja e gjedheve për qumësht	97	3.73
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	89	3.42
Fermtat e përziera	48	1.84
Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara	42	1.61
Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare	41	1.57
Kultivimi i drithërave (përveç orizit), i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore	38	1.46
Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta	36	1.38
Punime suvatimi	31	1.19
Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuara	27	1.04
Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara	29	1.11
Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara	21	0.81
Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara	26	1.00
Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.	40	1.54
Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm	94	3.61
Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit	87	3.34
Furnizimi me ushqim me porosi për raste	26	1.00
Aktivitetet shërbyese të pijeve	42	1.61
Tjera*	1139	43.74
Gjithsej	2604	100.00

Tabela 4.5: Shpërndarja e bizneseve private aktive, sipas veprimtarisë (Dhjetor, 2016)

Burimi: Komuna e Istogut, 2016, Zyra për regjistrim të bizneseve

*Veprimtaritë që kanë më pak se 20 firma në kategori janë të grupuara në të tjera.

Bizneset në Komunën e Istogut janë kryesisht individuale (mbi 90%), shoqëri me përgjegjësi të

kufizuar (afër 8%) dhe pjesëmarrje të vogël të ortakërive të përgjithshme (1%) (Tabela 4.6)

Biznese Individuale	2354	90.40
Ortakëri e përgjithshme	27	1.04
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	207	7.95
Shoqëri Aksionare	7	0.27
Koperativa Bujqësore	6	0.23
Kompani të huaja	3	0.12
Gjithsej	2604	100.00

Tabela 4.6.: Struktura e Bizneseve sipas pronësisë (Dhjetor, 2016)

Burimi: Komuna e Istogut, 2016, Zyra për regjistrim të bizneseve

Për të zhvilluar sektorin privat dhe objektivat e zhvillimit ekonomik lokal të komunës së Istogut, që krijon mundësi punësimi për të gjithë qytetarët, komuna ballafaqohet me disa sfida. Nivele më të larta të të arriturave arsimore, që do t'u jepnin qytetarëve shansin më të mirë të arritjes së suksesit në jetën e tyre. Zhvillimin e potencialeve turistike me tendencat për mbrojtjen e tokës bujqësore, vendbanimit, peizazhit dhe mjedisit. Një ndër prioritetet kyçe të kësaj strategjia janë: mbështetja e rritjes së bizneseve, tërheqja e bizneseve të reja në komunë, rritja e punësimi, përmirësimi i infrastrukturës kritike.

Punësimi

Norma e punësimi në komunën e Istogut është mjaftë e ulët, duke marrë për bazë numrin e popullsisë aktive për punë. Po ashtu, ka mungesë të shkathtësive në punë, sidomos të shkathtësive praktike në zgjidhjen e problemeve të cilat kërkojnë nga sektori privat. Shumica e të punësuarve në kompanitë private, edhe pse me përvojë, nuk janë formalisht të certifikuar. Ofrimi i trajnimeve profesionale (formale) për të punësuarit e sektorit privat është i mangët, edhe pse kohëve të fundit vërehet një aktivitet më i dendur në këtë drejtim (p.sh. Projekti për ngritjen e shkathtësive për teknologji informatike i financuar nga BE). Sipas të dhënave të vitit 2012, numri i të punësuarve në sektorin publik është 2015, ndërsa në sektorin privat llogaritet përafërsisht se janë të punësuar 2493 punëtorë, në sektorin joformal 1150 punëtorë, ndërsa në bujqësi llogariten përafërsisht 4200 persona që krijojnë të ardhura nga kjo lëmi. Sipas shënimeve të Zyrës Komunale të Punësimi, të evidentuar si të papunë janë 5954 persona, prej tyre 3668 meshkuj, ndërsa 2286 femra. Realisht numri i të papunëve është disa herë më i madh

Komuna, më saktësisht Drejtoria e Bujqësisë do t'u sigurojë ndihmë fermerëve me ferma të cilësdo madhësi (duke i përfshirë këtu edhe ato tepër të vogla) për t'u kualifikuar për mbështetjen nga subvencionet e Ministrisë së Bujqësisë për vitet 2016-2018 dhe me një program të promovuar nga vet komuna, i cili tërheq mbështetje financiare nga qeveria. Komuna është duke u angazhuar tash sa vite me institucionet e tjera për të krijuar dhe për të ofruar projekte në ndihmë të sektorit bujqësor dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë si një çështje me prioritet.

se numri i të evidentuarve në Zyrën Komunale të Punësimi. Duke marrë parasysh numrin e popullsisë aktive (25.921) dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve (9.938), del se shkalla e punësimi në komunën e Istogut është 36 %. Ndërsa, shkalla e papunësisë llogaritet në 64 %, shkallë e cila është mjaft e lartë. Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se rreth 25 % të popullsisë që jetojnë në qytet janë të punësuar. Prej të tjerëve, 13 % jetojnë me ndihma sociale, ndërsa një pjesë e popullatës burimin e të ardhurave e kanë nga pensioni (nga buxheti i Kosovës), rreth 38 %, kurse pjesa tjetër nga ndihmat që u dërgojnë familjarët dhe të afërmit që i kanë të punësuar në botën e jashtme.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në administratën komunale, 157 sish, të gjinisë mashkullore janë 118, kurse të gjinisë femërore janë 39. Në arsim, nga 689 të punësuar, 360 janë të gjinisë mashkullore dhe 289 të gjinisë femërore, ndërsa në shëndetësi, nga 123 gjithsej të punësuar, të gjinisë mashkullore janë 32, kurse të gjinisë femërore 91 sosh. Nga kjo skemë del se punësimi i femrës në komunën e Istogut është mjaftë i avancuar, e që përfshin rreth 40 % të të punësuarve.

Zhvillimi rural

Gjeografia

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Komuna, në veriperëndim kufizohet me Malin e Zi dhe me Serbinë, në verilindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jugperëndim me komunën e Pejës.

Qendër komunale është qyteti i Istogut. Komuna ka 50 vendbanime prej të cilave 1 është qytet - Istogu dhe 2 vendbanime me karakter qyteti Gjura-koci dhe Banja, vendbanimet e tjera janë fshatra.

Komuna e Istogut sot ka sipërfaqe prej 453.84 km² kjo paraqet 4.17 % të sipërfaqes së Kosovës. Territori i komunës së Istogut shtrihet në lartësi të ndryshme mbidetare. Pjesa fushore, ku është e lokalizuar prodhimtaria kryesore bujqësore është në lartësi mbidetare 400-650 m, ndërkaq në regjionin e bjeshkëve të Istogut kjo lartësi arrin në disa pjesë edhe në mbi 2000 m. Vendbanimi qendror i komunës së Istogut, që me rrethinën e saj shtrihet në sipërfaqe me pjerrësi prej 5° deri në 10°, me lartësi absolute të territorit të ngushtë prej 500 m, gjendet në zonën jugperëndimore.

Klima

Komuna e Istogut karakterizohet me klimë kontinentale të butë, në të cilën ndikim të madh ka afërsia e kurorës malore të Bjeshkës së Mognës nga pjesa veriore, që ka ndikim të madh në ndryshimin e shpeshtë të temperaturës gjatë ditës.

Ky territor nuk ndryshon shumë sipas kushteve të temperaturës nga territoret e tjera të pjesës veriore të Rrafshit të Dukagjinit, të cilat janë në një pjesë të madhe nën ndikimin e klimës kontinentale dhe që kanë më pak nxehtësi dhe më tepër të reshura. Temperatura mesatare mujore silllet prej -0.5°C në janar e deri në 23.3°C në gusht. Temperatura mesatare vjetore është 11.3°C, ndërsa në periudhën vegjetative 17.6 °C Sasia vjetore e të reshurave është mesatarisht rreth 740 mm. Shumica e këtyre reshjeve bien në periudhën tetor-

mars, ndërsa në periudhën prill-shtator (kur është periudha vegjetative), të reshurat janë dukshëm më të pakta.

Gjatë periudhave kur të reshurat janë të shpeshta dhe pas shkrirjes së borës, sasia e ujit rritet duke krijuar përmytje (vërshime). Faktorë të tjerë që shkaktojnë vërshime janë edhe mbeturinat nëpër lumenj, si dhe rrokullisjet e gurëve nga bjeshkët.

Territori i komunës së Istogut përshkohet nga disa lumenj si: lumi i Istogut, lumi i Vrellës dhe Drini i Bardhë. Përveç këtyre lumenjve, ekziston edhe një numër i konsiderueshëm i rrjedhave më të vogla të përhershme dhe të përkohshme. Është shumë e nevojshme që këta lumenj të pastrohen nga mbeturinat e shumta që hidhen në ta nga banorët lokalë, si dhe të rregullohet shtrati i tyre.

Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 70 %, ndërsa gjatë sezonit vegjetativ 63 %, që këtij territori i japin karakterin e hapësirës me lagështi mesatare të ajrit.

Territori i komunës së Istogut është i njohur për erërat e intensitetit relativisht të lartë deri në 27 m/s, që fryjnë nga drejtime të ndryshme. Dominojnë ato perëndimore (2.8 m/s) dhe jugperëndimore (2.4 m/s), që konsiderohen të shpejtësisë së vogël (6.64-10 km/h) Këto erëra shpeshherë shkaktojnë dëme në bujqësi dhe në objekte të ndryshme.

Bujqësia

Sektori i bujqësisë në komunën e Istogut konsiderohet si sektori më i rëndësishëm nga aktivitetet e përgjithshme ekonomike. Pas luftës, donatorë të ndryshëm ndihmuan në rimëkëmbjen e këtij sektori, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë. Përkundër mungesës së investimeve dhe mungesave të tjera të këtij sektori, prodhimi bujqësor u ngrit gradualisht. Sot ky sektor merret me prodhimin e drithërave, pemëve, perimeve si dhe prodhimeve të mishit.

Sipas KRU Drini i Bardhë - Pejë sipërfaqja e projektuar për ujitje është 11,700 ha, ndërsa sipërfaqja të mundshme për ujitje janë 4580 ha. Në pikëpamje të kushteve orografike, territori i komunës së Istogut ka kushte të volitshme për prodhimin e bimëve, për arsye se deri në 600 m të lartësisë mbidetare gjenden 23240 ha, apo 51.19 % e sipërfaqes bujqësore. Lugina e lumit Shushicë dhe e lumit të Istogut konsiderohen si sipërfaqe ku mund të organizohet prodhimi i bujqësisë dhe prodhimet kopshtare.

Sipërfaqet e lartësisë mbidetare 500-600 m janë të përshtatshme për prodhime bujqësore dhe të pemëve, sidomos në pjesën lindore të komunës në drejtim të Rakoshit. Sipërfaqet e lartësisë mbidetare prej 600-700 m mund të shfrytëzohen pjesërisht, ndërsa sipërfaqet mbi 700 m, të cilat e përbëjnë rreth 40 % të territorit të komunës, mund të shfrytëzohen për kullosa dhe një pjesë tjetër për pyje. Toka e territorit të komunës së Istogut është mjaft heterogjene, sepse përmban shumë tipe dhe nëntipe.

Bujqësia në komunën e Istogut karakterizohet me përpjekje të kalimit nga bujqësia e ekonomisë familjare në atë gjysmëkomerciale dhe komerciale. Sipërfaqja mesatare, të cilën ekonomitë familjare e shfrytëzojnë për aktivitete bujqësore, është 1.6 ha. - fermat të cilat përbëjnë 17 % shfrytëzojnë ~1ha.

Shumica e familjeve posedojnë sipërfaqe të tokës mjaft të vogël dhe në shumicën e rasteve të shpërndarë në disa parcela. Ky faktor është kufizues për aplikimin e teknologjive bashkëkohore në prodhimtarinë bujqësore në përgjithësi. Sipërfaqet e tokës së punueshme i janë nënshtruar shkatërrimit të pakontrolluar. Ndërtimi i shtëpive pa plan, objekteve të tjera përcjellëse (të cilat do të mund të ndërtoheshin në toka më pak cilësore), kanë bërë që fondi i tokës bujqësore të zvogëlohet në vazhdimësi. Gjithashtu, është mjaft shqetësues fakti se kjo tendencë është duke vazhduar edhe tani.

Edhe pse që nga paslufta janë bërë investime mjaft serioze në infrastrukturën e këtyre fshatrave (kryesisht në rregullimin e rrugëve, ambulancave, ujësjellësit, kanalizimit etj.), megjithatë problemet e grumbulluara për shumë vite në këtë lëmi kërkojnë vazhdimësi dhe zgjerim të aktiviteteve në këtë drejtim.

Rendimentet e kulturave bujqësore në Istog (edhe pse janë më të mira se në disa regjione të tjera të Kosovës, sidomos pemët dhe perimet) marrë në përgjithësi janë shumë të ulëta në krahasim me potencialet gjenetike të kulturave që sot kultivohen tek ne, si dhe në raport me vendet e BE-së. Faktorët që ndikojnë në këtë situatë janë: fermat e vogla, kostoja e lartë e prodhimit, mospërshtatja e prodhimit kërkesave të tregut, mungesa e mjeteve financiare për investime, etj.

Komuna e Istogut ka një potencial të madh në sektorin e bujqësisë, pasi ka tokë cilësore, klimë të volitshme dhe burime ujore, si dhe kapacitet të mjaftueshëm njerëzor për prodhimtari bujqësore. Bujqësia është një sektor i rëndësishëm pasi angazhon, direkt apo indirekt, një numër të madh të njerëzve dhe siguron ushqim cilësor për konsumatorët vendorë. Investimet në bujqësi (megjithëse ka përkrahje mjaft serioze) janë ende të pamjaftueshme, pasi mungojnë kreditë e volitshme, mungon profitabiliteti në fermë, rreziku i investimeve është i lartë, investimet e jashtme janë minimale, infrastrukturë dhe organizim të dobët të tregut dhe mungesë të njohurive të funksionimit të tregut dhe marketingut të produkteve.

Industria përpunuese është jashtëzakonisht e rëndësishme për Istogun, pasi e rrit vlerën e produkteve bujqësore. Edhe pse ekziston një potencial për këtë sektor, problemet me menaxhimin e dobët si dhe konkurrenca e ashpër nga vendet e tjera kanë ndikuar që sektori i përpunimit të prodhimeve bujqësore të jetë i zhvilluar dobët. Vetëm një pjesë tepër e vogël e prodhimit vendas përpunohet.

Komuna e Istogut është e njohur me kultivimin e peshkut dhe me prezencën e hurdhave. Prej sipërfaqeve ujore, afër 9 ha janë hurdha. Kompleksi për kultivimin e troftës është atraktiv për vizitorët e vendit dhe të huaj, si dhe krijon kushte të mira për zgjerimin e kapaciteteve të prodhimit të një rrjeti më të gjerë të aktiviteteve. Brenda qytetit të Istogut hasim edhe 6 hurdha të tjera, por të kapaciteteve më të vogla. Hurdha të tjera të këtyre kapaciteteve i hasim edhe në disa vende të tjera në territorin e komunës së Istogut. Pra, prodhimi i peshkut konsiderohet një veprimtari me rëndësi për komunën dhe ka perspektivë në zhvillimin e mëtejshëm, duke u bazuar në pasurinë e ujërave (kapacitet ekzistues në Istog, "Trofta" dhe prodhuesit e tjerë të vegjël).

Fermerëve të Istogut u nevojitet përkrahja në sigurimin e qasjes së bujqve në kapital investues. Kjo arrihet duke siguruar mbështetje financiare për investimet në teknologjitë konkurruese, që është shumë e shtrenjtë për fermerët që kanë pak resurse. Nevojitet një investim serioz në përmirësimin e infrastrukturës së fshatit, e posaçërisht rrugëve për qasje në parcela, zgjerimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të ujitjes.

Meqenëse fermat janë shumë të vogla, në shumë raste të ardhurat nga to nuk mjaftojnë për një mirëqenie të familjeve rurale. Për këtë arsye është shumë i nevojshëm siguri i të ardhurave shtesë për bujqit dhe banorët ruralë, duke ndikuar në përmirësimin e standardit të jetesës dhe kushteve të punës në viset rurale, sidomos përmes diversifikimit rural (shfrytëzimit të të gjitha resurseve rurale). Pra, duhet ndihmuar edhe aktivitetet e tjera jobujqësore, siç janë artizanatet e ndryshme, ndërmarrjet e vogla përpunuese, etj.

Është shumë i nevojshëm përmirësimi i përpunimit dhe tregtimit të prodhimeve bujqësore dhe pyjore, përmes efikasitetit dhe aftësive të shtuara konkurruese përmes përmirësimit të cilësisë në fermë/fabrikë dhe standardeve të higjienës. Ndërtimi i qendrave grumbulluese për pemë dhe perime duhet të vazhdojë, pasi që kjo punë ende është në fazën shumë fillestare. Përmes promovimit të bujqësisë dhe veprimtarive të tjera ekonomike që

janë në harmoni me mjedisin, që do të rezultojë me krijimin e vendeve të punës në viset rurale.

Puna e pushtetit lokal duhet përmirësuar për të bërë kontroll të rregullt shëndetit të farës, bimëve, kemikateve, plehrave, në bashkëpunim me inspektoratin fitosanitar në nivel regional dhe nacional. Duhet përmirësuar cilësinë e inputeve (farës, plehut, pesticideve, makinerisë) si dhe rritja e shfrytëzimit të përbashkët i makinerisë dhe depove eventuale për të ulur koston e prodhimit

Për bujqësinë e komunës së Istogut është me shumë rëndësi rikonstruimi i sistemeve ekzistuese dhe ndërtimi i sistemeve të reja për ujitje, rregullimi i rrjedhave ujore, ngritja e pllëshmërisë së tokës, rregullimi i vendbanimeve të fshatrave, shfrytëzimi racional i sipërfaqeve dhe rregullimi i tyre, parandalimi i ndotjes së sipërfaqes, parandalimi i depupollarizimit të fshatrave, sidomos atyre kodrinore dhe malore, përmes një barazimi të kushteve për jetesë dhe punë, ndalimi i ndërtimeve të pakontrolluara në tokat bujqësore, pajisja e tokave me infrastrukturë për nevojat e bujqësisë.

Pylltaria

Komuna e Istogut, sipas lokacionit gjeografik të territorit, shtrihet në pjesën më veriore të Rrafshit të Dukagjinit, respektivisht është kryesisht vend malor. Pyjet janë pasuri në vete për komunën e Istogut. Ato mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të këtij territori. Dikur, sidomos pyjet e dushkut mbulonin një pjesë të konsiderueshme të rrafshinës së sotme pjellore, ku sot vendin e tyre e zënë drithërat dhe kulturat e tjera bujqësore. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të pyjeve të vitit 1961, sipërfaqet nën pyje janë 19.220 ha, në sektorin shoqëror janë afro 13.570 ha apo 68,8 %, ndërsa në sektorin privat 5.650 ha, apo 32,2 %. Nga sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në Kosovë (490.000 ha), Istogu me sipërfaqe nën pyje merr pjesë me 3,92 %.

Roli prodhues i pyjeve të Istogut është mjaft i rëndësishëm, duke iu falënderuar strukturës së sipërfaqeve pyjore. Prodhimi i tanishëm i pyjeve të territorit të Istogut është zvogëluar dukshëm nga prerjet e egra të paraluftës dhe ato ilegale, që janë mjaft të larta edhe sot. Funkzioni më i rëndësishëm i pyjeve është se ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe mënyrat e ndryshme të zhveshjes dhe kanë ndikim në karakteristikat klimatike, në pengimin e vërshimeve të sipërfaqeve bujqësore dhe vendbanimeve në pjesët pranë bregut të ujërave. Nuk ka pyje për destinim të veçantë, kryesisht kanë karakter ekonomik dhe vetëm ekonomiko-komercial.

Problemet kryesore të identifikuara edhe më herët janë ndërtimi i pamjaftueshëm i rrugëve pyjore, masat joadekuate bashkëkohore të pajisjeve dhe prestrukturimit të fondit të pyjeve (shkurre ka afro 17 %), që janë rezultat i investimeve të pamjaftueshme.

Aktivitetet jobujqësore dhe turizmi rural

Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje dhe kufizimet e tjera, vërehet se është shumë e nevojshme që në zonat rurale të Istogut, një rëndësi të posaçme duhet kushtuar nxitjes së kulturës ndërmarrëse dhe zhvillimit edhe të aktiviteteve jobujqësore (në zonat rurale), që do të thotë bizneseve familjare komplementare. Kjo është posaçërisht e mundshme duke pasur në konsideratë trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Istogut.

Në këtë drejtim ka shumë pak aktivitete, qoftë nga banorët e zonave rurale apo edhe nga institucionet të cilat duhet përkrahur këto aktivitete, të paktën në fazat fillestare. Këto aktivitete do të ndikojnë shumë në rritjen e punësimit dhe në rritjen e përgjithshme të mirëqenies në zonat rurale. Këto aktivitete përfshijnë përpunimin e ushqimit, bujtinat dhe ofrimi i shërbimeve hoteliere, produktet bujqësore, bizneset për grumbullimin e kërpudhave dhe frutave të tjera pyjore, bletarinë, bimët mjekuese, etj. Përpunimi i produkteve bujqësore është fare i vogël. Një mundësi tjetër, që është pothuajse e panjohur për banorët e këtyre zonave,

ka të bëjë me turizmit rural, për zhvillimin e të cilit në disa regjione rurale të Istogut ka kushte shumë të favorshme. Istogu zhvillimin e vet e mbështet në resurset njerëzore dhe natyrore, në traditën e popullatës së kësaj ane dhe në kërkesat e ekonomisë së tregut. Istogu llogaritet si një vend i potencialit dhe traditës bujqësore, me agrikulturë, blegtori, peshkatari dhe pylltari të zhvilluar, andaj ka mundësi të mëdha për nxitjen e turizmit rural.

Turizmi

Trashëgimia kulturore, përmes zbulimeve arkeologjike, tregon se në zonat e Istogut ishte i pranishëm procesi i organizuar i jetës urbane qysh nga kohërat më të lashta. Në këtë komunë janë disa monumente të trashëgimisë kulturore si: kala, kisha ortodokse, kulla, xhami, mullinj, mejtepe, sharrë uji etj. Komuna e Istogut ka 104 monumente kulturo-historike, një numër i konsiderueshëm i të cilave janë të vizitueshme.

Resursi strategjik i turizmit duhet të mbetet hapësira me shumë vlerë, deri tani e ruajtur, që në afat të gjatë do të ketë rëndësi. Fizionomia e elementeve tërheqëse të Istogut udhëzon qartë në rajonet malore, drejtimet e turizmit transit, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lokalitetet e gjuetisë dhe fshatrat.

Oferta turistike e Istogut mund të bazohet në:

- Peizazhet masive malore, që kanë kapacitet të konsiderueshëm pranimi, natyra e ruajtur, sidomos flora dhe fauna,
- Lartësitë malore që arrijnë mbi 2155 m, me kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e turizmit veror e dimëror;
- Rrjeti i vendbanimeve me ofertën e organizuar të serviseve shërbyese, që lidhen me korridoret kryesore të komunikacionit, si sistem hapësinor i zhvillimit të qarkullimit dinamik;
- Pasuria, shumëllojshmëria etnike dhe kulturore, por edhe tërësitë e ruajtura kulturore historike dhe monumentet e veçanta, midis të cilëve ka të tilla që janë atraksione unike, për një klientelë të caktuar;

- Oferta turistike e ekskursioneve ditore dhe të fundjavës, në bazë të elementeve ekzistuese natyrore, që ka si qëllim rekreacionin dhe pushimin e vazhdueshëm të banorëve.

Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik, komuna e Istogut ndahet në tri zona turistike: Zona turistike e qytetit të Istogut me rrethinë, Zona turistike e Bjeshkëve, Zona turistike e Banjës.

Pozita gjeografike, klima, drejtimet e transitit, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lokalitetet e gjuetisë dhe fshatrat, ofrojnë mundësi për zhvillimin e këtyre formave të turizmit: Turizmi dimëror, turizmi veror, turizmi kulturor, turizmi rural, gjuetia dhe peshkimi, turizmi shëndetësor, ekskursionet, turizmi konferencial; turizmi transit etj.

5. Organizimi i shërbimeve publike

Sektori i shërbimeve publike në komunën e Istogut funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e cila realizon detyrat e veta të organizuara në dy sektorë, duke përfshirë edhe shërbimet e përbashkëta (zyrtarët e komunës në kuadër të DSHPMSH).

Marrë në përgjithësi, detyrat e kësaj drejtorie, përfshirë të dy sektorët, janë: ofrimi i shërbimeve publike lokale, duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, përpunimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe trotuareve të qytetit dhe rrugëve lokale, ndriçimin publik, semaforët dhe transportin publik; detyra këto të përshkruara dhe të ndara në bazë të vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale.

Roli dhe përgjegjësitë e komunës në zhvillimin e infrastrukturës publike

Menaxhimi i sistemit të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në komunën e Istogut bëhet nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit „Hidrodrini“, e cila është e licencuar për këtë qëllim. Ndërkaq menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut bëhet nga komuna e Istogut, përmes kontraktorëve të jashtëm.

Duke pasur parasysh rëndësinë e infrastrukturës së ujësjellësit, ujërave të zeza dhe ujërave të shiut, për kualitetin e jetës, mirëqenien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, padyshim që komuna ka një rol të

rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, po ashtu edhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza. Rrjedhimisht, planet zhvillimore dhe urbanistike të komunës duhet të harmonizohen me planet e investimeve kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në territorin e saj administrativ.

Në këtë kontekst, ekipi i strategjisë është udhëhequr nga parimi që projektet e ujësjellësit dhe të ujërave të zeza që janë përfshirë me këtë projekt-propozim të jenë rezultat i konsultimeve me KUR „Hidrodrini“ dhe të korrespondojnë me planet investive të kësaj kompanie, duke qenë po ashtu në korelacion me planet zhvillimore të komunës së Istogut.

Në anën tjetër, infrastruktura e kanalizimit të ujërave të shiut është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e komunës, për të cilën nuk ekziston një kompani publike e as departament komunal i veçantë përgjegjës për menaxhim dhe mirëmbajtjen e saj. Si pasojë e saj mungon pasqyra e plotë e gjendjes ekzistuese dhe projektet e planifikuara, kështu që GP (grupi punues), me rastin e hartimit të projekteve të propozuara për këtë infrastrukturë, është bazuar në të dhënat nga Kuvendi Komunal i Istogut dhe Kompania e Ujësjellësit.

Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së ujësjellësit

Programi i infrastrukturës – furnizimi me ujë dhe kanalizimi, synon rehabilitimin dhe rindërtimin e qëndrueshëm të infrastrukturës në Kosovë. Objektivi kryesor i projektit është krijimi i organizuar, teknik dhe financiar i shërbimeve komunale të ujit në bazë të principeve të ekonomisë së tregut.

Në kompanitë e ujit “Hidrodrini”, në Njësinë e Istogut, ofrimi i shërbimeve konsumuese të besueshme sa i përket mbulimeve të shpenzimeve dhe të operimit të shërbimeve komunale si kompa-

ni efikase do të ilustruhet me shembuj. Ky raport merret vetëm me elementet e projektit që përquendohen në përcaktimin e vlerave në Istog. Raporti përfshin rezultatet dhe përfundimet e studimeve në terren.

Sistemi i ujësjellësit të Istogut e merr ujin nga burimi i Istogut, Javorit, Vojdullit, Vrellës, si dhe një pjesë e furnizimit bëhet nga burimi i Drinit të Bardhë. Kapaciteti i të gjitha burimeve është $Q=20.380 \text{ m}^3/\text{ditë}$. Në tabelë janë paraqitur fshatrat të cilat shërbehen me ujë të pijshëm.

Njësia e Istogut			
Nr.	Emri i burimeve	Kapaciteti- $\text{m}^3/\text{ditë}$	l/s
1	Istogu	29,376	340
2	Javori	0.508	5.87
3	Vojdulli	0.827	9.57
4	Vrella	2,505	29

Tabela 5.1.: Burimet kryesore ujore

Burimi: Komuna e Istogut, 2016

Gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë, sidomos në pikat kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta). Arsyt kryesore për probleme të tilla konsistojnë në faktin se humbjet e ujit në sistemin e transmisionit dhe në sistemin distributiv janë në një shkallë jashtëzakonisht të lartë - rreth 60 %. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Pra, ato përfshijnë humbjet komerciale dhe humbjet fizike/teknike. Proporcioni i këtyre dy kategorive të humbjeve nuk dihet saktësisht, por vlerësohet të jetë 50 % / 50 %. Faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e lartë të humbjeve vlerësohet të jenë: rrjeti i vjetruar i ujësjellësit, kççjet ilegale, mosmatja e saktë e ujit.

Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit, në formën që në burimet e ujit ekzistojnë stacionet e klonimit, ku klorohet uji konform standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore. Sistemi i furnizimit me ujë është i ndarë në 2 zona: (I) zona e epërme, që furnizohet me ujë përmes sistemit të pompimit, dhe (II) zona e poshtme, që furnizohet me ujë me rrjedhje me gravitacion.

Rrjeti i kanalizimit

Sistemi i kanalizimit për qytetin e Istogut është ndërtuar në vitin 1972, 2004, 2008, në gjatësi 20.900 m, si sistem i tipit të ndarë: sistemi i veçantë për largimin e ujërave të zeza nga sistemi i largimit të ujërave të shiut. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza në Gjurakoc ka filluar të ndërtohet në vitin 1994, 2007, në gjatësi prej 17.200 m.

Problemet kryesore që kanë të bëjnë me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza në komunën e Istogut janë: (I) mospërfshirja e disa zonave urbane të qytetit, (II) mospërfshirja e zonave rurale, dhe (III) dimensionet joadekuate të rrjetit (si pasojë e rritjes së popullatës). Ndër problemet kryesore të funksionimit të rrjetit të kanalizimit janë mbledhja e pamjaftueshme e ujërave të zeza dhe derdhja e ujërave të zeza pa trajtim.

Qyteti i Istogut ka vetëm rrjetin e kanalizimit fekal, përderisa mungon ai atmosferik. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit është bërë pa ndonjë planifikim të mirëfilltë, varësisht prej nevojave të kohës dhe mjeteve materiale në dispozicion. Si pasojë është se dimensionet e gypave janë joadekuat dhe në shumë vende sjellin probleme të caktuara. Gjithashtu, edhe mirëmbajtja e rrjetit është shumë e vështirësuar. Vështirësi sjell edhe mospagesa e rregullt e qytetarëve për shërbime. Si në çdo vend në Kosovë, edhe në këtë rast rol dominues në shpërndarjen e rrjetit të kanalizimit ka luajtur konfiguracioni i terrenit. Kështu, të gjitha ujërat e zeza, pa përjashtim, shkarkohen në lumit e qytetit, në Istog. Shkarkimi i ujërave të zeza bëhet pa ndonjë trajtim paraprak, duke e ndotur ujin e lumit. GP ka paraparë sistem të ndarë të kanalizimit, gjegjësisht një rrjet të kanalizimit fekal dhe një rrjet të kanalizimit atmosferik.

Menaxhimi komunal i energjisë

Komuna e Istogut kryen shërbime të ndryshme dhe të shumta për qytetarë, është përgjegjëse për mbarëvajtjen e administratës komunale, mbarëvajtjen e arsimit parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë; komuna ka përgjegjësi për nivelin primar shëndetësor. Gjithashtu, në lëminë e infrastrukturës ofron shërbime për sigurinë në qarkullim nëpërmjet ndriçimit rrugor, si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të ndriçimit të rrugëve, furnizim me lëndë djegëse për objektet që ka në menaxhim etj.

Në përgjithësi, komuna është përgjegjëse për mbulimin e shpenzimeve për ngrohje - ftohje, ndriçim, operim normal të sistemeve të instaluar, për furnizim me ujë të ngrohtë në të gjitha ndërtesat shëndetësore primare, objektet shkollore, administrative, kulturore dhe sportive që gjenden në territorin e saj. Sektori i banimit është shumë me rëndësi për t'u trajtuar në aspektin e konsumit të energjisë, por menaxhimi i energjisë në këto ndërtesa nuk është në kompetencat komunale. Përgjegjës për ofrimin e shërbimeve dhe furnizim me energji elektrike është kompania e distribuimit të energjisë elektrike KEDS.

Rrjeti elektrik

Në aspektin e mirëmbajtjes së rrjetit, si dhe furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike, i tërë konsumi elektrik i Istogut, në nivelin shpërndarës, menaxhohet dhe eksploatohet nga distrikti i Pejës. Në aspektin e planifikimit të zgjerimit të rrjetit shpërndarës kjo njësi disponon vetëm me shënimet nga terreni. Po ashtu, implementimin e projekteve të reja, kjo njësi punuese vetëm e garanton nga aspekti i sigurisë elektrike, si dhe merr pjesë në komisionet teknike të objekteve të reja për nivelin shpërndarës. Zona e Istogut furnizohet nga trafostacioni TS Istogu 110/10 kV/kV, me fuqi instaluese 1x 31,5 MVA. Ky trafostacion furnizohet përmes linjave të nivelit 110 kV, nga drejtimi i TS Vallaqit përmes linjës nr. 126/4, dhe nga drejtimi i TS Peja I përmes linjës nr. 126/3. Të dy linjat janë të seksionit 150 mm². Përkundër faktit se linjat në fjalë janë ndër më të vjetrat në Kosovë, mirëmbajt-

ja e tyre ka bërë që të mos vijë në pyetje furnizimi i vazhdueshëm i TS Istogut. Vlen të potencohet se këtu furnizimi përcillet me parametra nën vlerat e lejuara teknike, si pasojë e rënieve të mëdha të tensionit. Ndërtimi i trafostacionit të ri në fshatin Veriq ka krijuar linjat e reja nga Istogu për Pejë, Klinë dhe Skenderaj në nivelin 110 kV, si dhe lidhja me trafostacionin Peja III. Me këto projekte, definitivisht, furnizimi me rrymë i Istogut do të sigurohet në shkallën më të lartë.

Kërkesat për furnizim me energji elektrike për vitet e ardhshme është vlerësuar të rriten me një normë prej 5-6 % në vit në nivel vendi, ndaj është e qartë se në të ardhmen e afërt duhet të ndërtohen kapacitete të reja gjeneruese, të cilat duhet të jenë kryesisht termike. MZHE dhe AKEE posaçërisht, të mbështetura nga BE-ja, po punojnë fuqishëm për të promovuar dy aspektet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e zvogëlimit të konsumit të energjisë: promovimin e EE-së si dhe promovimin e aplikimit të BRE-ve. Sektori i ndërtesave publike dhe atyre të amvisërisë është një nga sektorët më të rëndësishëm të konsumit të energjisë në nivel komune. Rëndësia e tij rezulton në faktin që ky sektor konsumon sasi të mëdha të energjisë si asaj elektrike ashtu edhe të lëndëve djegëse fosile, që kryesisht përdoret për ngrohje dhe gatim (dru zjarri, thëngjill, gaz LPG, ..., etj.)

Tani për tani, konsiderohet se sektori i amvisërisë në komunën e Istogut në përdorim të gjerë kanë drutë e zjarrin për ngrohje dhe gatim. Ngarkesa në rrjetet shpërndarëse ngelet e lartë, për shkak të konsumit të energjisë elektrike edhe për ngrohje, edhe pse në shumicën e zonave rurale dhe urbane në këtë rajon lënda djegëse-dru zjarri është një nga burimet kryesore të lëndës djegëse për ngrohje dhe gatim në të gjitha amvisëritë. Për pasojë, ekziston një mospërputhje e dukshme në mes kërkesës për energji dhe furnizimit, e cila çon në mbingarkesa në rrjet dhe ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike, edhe pse konsumimi i lëndës djegëse drusore ngelet i lartë dhe kjo si pasojë e shtëpive jo mirë të izoluar dhe me humbje të mëdha të nxehtësisë.

Ndriçimit publik

Rrjeti i ndriçimit publik është i shtrirë kryesisht në zonat urbane të qytetit të Istogut (disa lagje nuk e kanë këtë shërbim), por edhe në Gjurakoc, në Banjë dhe në Vrellë pjesërisht është shtrirë ky shërbim, ndërsa fshati Baicë me vetorganizim e ka vendosur ndriçimin publik në shtylla të rrymës elektrike, të cilin rrjetet komuna e ka marrë në menaxhim të mëtejshëm. Në tabelën e mësipërme është paraqitur në mënyrë të detajuar gjendja momentale e ndriçimit publik në territorin e komunës së Istogut. Nga 22 km rrugë në zonat urbane, gjatësia totale me ndriçim publik është 12,5 km, kurse nga 81 km rrugë rurale me ndriçim publik mbulohen vetëm 2 kilometra, çka do të thotë se në komunën e Istogut në rrjetin e ndriçimit publik janë të përfshira një (1) për qind e gjatësisë së rrugëve të komunës së Istogut.

Shërbimi i pastrimit të mbeturinave në ekonominë familjare

Menaxhimi i shërbimit të mbeturinave në ekonominë familjare në zonat urbane bëhet në baza ditore ndërsa në zonat rurale sipas marrëveshjes dhe sipas nevojës, së paku një herë në javë, dy herë në muaj ose edhe një herë në muaj. Numri i ekonomive familjare në komunën e Istogut është 6582 ndërsa kompania mbulon vetëm 1613 ekonomi familjare dhe 352 biznese. Kompania publike kryesore për menaxhimin e mbeturinave është KRM "Ambienti" në Istog.

Aktiviteti kryesor i KRM "Ambienti" në Istog është zbrazja e kontejnerëve 1.1 m³ për mbeturina dhe bartja e tyre në deponinë komunale në Tuqep të Istogut. Ajo ofron shërbime në zonat urbane dhe në ato rurale. Në zonat urbane shërbimet arrihen deri në 90 % ndërsa në zonat rurale afërsisht 30 % shërbimet ofrohen në bazë të marrëveshjeve të veçanta me kontrata. Si punë kontraktuese më e rëndësishme për mirëmbajtjen e ambientit mund të ceket kontrata e komunës me KRM "Ambientin" për fshirjen e rrugëve dhe trotuareve, si dhe larjen e rrugëve të qytetit. Sipas marrëveshjes, gjithashtu ka shërbime të kontraktuara me disa biznese si hotele etj., të cilat gjenden jashtë qytetit. KRM

“Ambienti” në Istog menaxhon me 23 punëtorë, posedon makinerinë adekuatë për kryerjen e shërbimeve që i ofron, por kjo makineri, që ishte donacion i shoqatave të ndryshme nga jashtë, tani veç është e amortizuar, prandaj edhe shpenzimet operative si karburanti mirëmbajtja etj. janë të mëdha.

“Ambienti” problem kryesor e ka inkasimin, pasi që qytetarët e Istogut në masë të madhe nuk i kryejnë obligimet që i kanë ndaj kompanisë. Ajo aktualisht ofron shërbime për këto kategori në bazë të marrëveshjeve paraprake me qytetarë, siç janë: grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave, pastrimi i rrugëve, larja e rrugëve, mirëmbajtja e parqeve mirëmbajtja e varrezave, të cilat do të diskutohen shkurtimisht në vazhdim.

Grumbullimi i mbeturinave realizohet në dy mënyra si: shpërndarja e kontejnerëve me vëllim 1.1 m^3 dhe të atyre 7 m^3 . Ndërsa grumbullimi me qese të plastikës mbetet synim të aplikohet më shumë në arvizni. Fshirja e rrugëve dhe trotuareve bëhet në bazë të marrëveshjes mes komunës dhe “Ambientit”. Fshirja bëhet në baza ditore. Aktualisht pastrohen 26600 m^2 , ndërsa pastrimi i tregut bëhet një herë në javë, në një sipërfaqe prej 3000 m^2 . Larja e rrugëve bëhet në marrëveshje me komunën, larja bëhet sipas marrëveshjes dhe sipas nevojës. Kjo kompani ofron edhe shërbime të tjera si: pastrimi i borës mirëmbajtja e parqeve dhe mirëmbajtja e varrezave. Kompania me komunën nuk ka marrëveshje që të kryhen këto shërbime, por shpresohet se në të ardhmen do të kryhen edhe këto shërbime me kontratë të rregullt. Vlen të theksohet se sa i përket investimeve nevojiten donatorë, sepse, sipas gjendjes momentale financiare, kompania nuk është në gjendje që të bëjë ndonjë investim kapital.

Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit

Mirëmbajtja e pjesëve të gjelbëruara të qytetit dhe atë: mbjellja e luleve, fidanëve, kositja e barit, mbjellja dhe kositja - rregullimi i rrethojave të gjalla, krasitja e drurëve sipas nevojës etj., bëhet nga kompania rajonale e mbeturinave “Ambienti”, njësia në Istog. Istogu, edhe pse ka një ambient të gjelbëruar për shkak të pozitës gjeografike, e ku më se gjysma e sipërfaqes së tij është bjeshkë dhe male, nuk mund të mburret me ndonjë park të qytetit. Ekziston një park i vogël në qendër të qytetit, i cili më tepër është vend i grumbullimit të mbeturinave dhe papastërtisë, sesa që shfrytëzohet për pushim dhe rekreacion. Janë edhe disa lokacione të gjelbëruara, mirëpo nuk i plotësojnë parakushtet për parqe të mirëfillta për pushim dhe rekreacion. Parku më i madh dhe më i mirëmbajtur është parku i Banjës. Numri i parqeve e shesheve në komunë është shtatë (7). Totali i sipërfaqeve të parqeve dhe shesheve komunale, të cilat mirëmbahen rregullisht, është 68 hektarë, kurse numri i parqeve e shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm është tre (3) sosh.

6. Infrastruktura lokale dhe qëndrueshmëria urbane

Bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor në Kosovë, në nivel lokal çdo komunë është e obliguar të posedojë këto lloje të planeve hapësinore: Planin Zhvillimor të Komunës; Hartat zonale, Planet detale rregulluese. Komuna e Istogut ka të hartuar Planin Zhvillimor Urbane (Istog, Gjurakoc, Banjë, Vrellë, Rakosh dhe Staradran), dhe Planet Rregulluese Urbane (Istog, Gjurakoc, Banjë dhe Vrellë), Planin Lokal të Veprimit në Mjedis. Komuna e Istogut është e dedikuar që të ofrojë infrastrukturë adekuate për qytetarët dhe bizneset. Për këtë qëllim ka organizuar një strukturë funksionale të organizuar në disa sektorë.

Infrastruktura rrugore

Komuna e Istogut ka lidhje të mira me qendrat rajonale në Kosovë, po ashtu edhe me qytete të rëndësishme në shtetet fqinje. Rruga kryesore Mitrovicë-Pejë kalon në territor të komunës dhe disa rrugë e lidhin komunën me Prishtinën e Klinën. Masivet malore në pjesën veriore të komunës i vështirësojnë lidhjet rrugore të komunës me Malin e Zi, Serbinë dhe komunën e Zubin Potokut. Megjithatë, lidhje të mira me Rozhajën, Malin e Zi, realizohen përmes rrugëve Istog-Pejë-Rozhajë dhe Istog-Radac-Rozhajë. Ndërsa, përmes rrugës Istog-Rakosh-Cërkolez, komunikimi me pjesën veriore të Kosovës, si Zubin Potokun, është mjaft i vështirë, për shkak të rrugës së dobët që i lidhë këto lokalitete. Rrugët lokale në Istog sigurojnë lidhje të mira në mes qendrave të bashkësive lokale dhe kanë qasje kryesisht të mirë të gjitha vendbanimeve në rrjetin rrugor - komunal. Bazuar në funksionin e tyre në hapësirën e komunës, duke pasur parasysh lidhjen mes qendrave të bashkësive lokale, lidhjen e vendbanimeve dhe lidhjen me vendbanimet e komunave fqinje, është bërë kategorizimi i rrugëve lokale.

Në këtë kontekst duhet theksuar se nga gjithsej 22 km rrugë urbane, të asfaltuara janë 16 km, kurse nga 176 km rrugë lokale, të asfaltuara janë 81 km. Nga rrugët regjionale që gravitojnë nëpër komunën e Istogut, të asfaltuara janë tërësisht 65 km. Gjatësia e përgjithshme e rrugëve që janë përfshirë në planin komunal për mirëmbajtje dimërore është 117 km. Në komunën e Istogut, sa i përket infrastrukturës rrugore, rëndësi i është kushtuar edhe trotuareve dhe parkingjeve. Gjatësia e trotuareve të shtruara në asfalt, beton apo kupëza është 30 km, kurse të parregulluara janë 15 km trotuare. Në planin komunal për mirëmbajtjen e trotuareve, si larjen dhe pastrimin e tyre verës dhe dimrit, janë të përfshira 10 km. Numri i vendeve për qasje të personave me aftësi të kufizuara në trotuare është 12.

Transporti publik

Nga 50 fshatra sa ka komuna e Istogut përfshirja e qytetarëve në transportin publik është e mirë, përkatësisht 47 fshatra janë të përfshira në këtë lloj transporti. Kështu që numri i vendndalimeve të autobusëve të transportit publik është 120, kurse i vendndalimeve të autobusëve të pajisura me shenjëzim është 78, ndërsa numri i vendparkingjeve në rrugë dhe jashtë rrugëve është 12.

Lokacione të destinuara për parkim janë 2 sosh, numri i parkingjeve për persona me aftësi të kufizuar është 2 dhe numri i vendparkingjeve të rezervuara për taksit janë 7 sosh.

7. Arsimi, kultura, rinia dhe sporti

Arsimi

Komuna, përmes Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, kryen detyrat dhe obligimet e veta në përputhje me ligjet dhe rregullat e MASHT-it dhe në pajtim me Ligjin për Arsim në komunat e Republikës së Kosovës, Statutit e rregulloreve komunale që përcaktojnë përgjegjësitë ndaj procesit edukativo-arsimor të të gjitha niveleve. Kjo drejtori angazhohet, organizon dhe menaxhon aktivitete kulturore, rinore dhe sportive. Kryen edhe punë e detyra zyrtare të parapara me statusin dhe rregullat e organizimit brenda dhe jashtë komunës.

Në fushën e arsimit, Drejtorija për Arsim dhe Kulturë mbulon organizimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve edukativo-arsimore. Numri i institucioneve shkollore në komunën e Istogut: 5 kopshte të fëmijëve, 11 shkolla amë nëntëvjeçare, 15 paralele të ndara për shkollim fillor, 2 shkolla të mesme të larta dhe një paralele e ndarë e SHMT-profesionale “Rudina”, Burgu i Dubravës.

Struktura edukativo-arsimore përbëhet nga: niveli parashkollor 235 fëmijë (15 grupe); shkollimi special i nxënësve me aftësi të kufizuara me 18 fëmijë (2 paralele); niveli i arsimit të obliguar që përfshin nxënësit nga klasa e I-rë deri në klasën e IX-të, 7251 (308 paralele); niveli i mesëm i lartë: 2237 nxënës (70 paralele). Numri i përgjithshëm i nxënësve është 9.772 nxënës, plus paralelet speciale me 20 nxënës. Numri i të punësuarve në arsim është 654 veta, ku prej tyre 518 janë mësime-dhënës, 31 personel administrativ dhe 105 personel teknik-ndihmës.

Kultura

Kjo komunë ka 13 shkolla fillore, përfshirë një në Cërkolez dhe një në Osojan, gjashtë kopshte me 174 fëmijë dhe dy shkolla të mesme, përfshirë gjimnazin ‘Haxhi Zeka’ dhe shkollën teknike ‘Mithat Frashëri.’ Në arsimin parashkollor janë 449 nxënës, në arsimin fillor 4,292 nxënës, në arsimin e ulët 3,523 dhe në arsimin e lartë 1,978 studentë. Veç kësaj, janë edhe dy klasa për studentë me nevoja të veçanta me 22 nxënës të moshave të ndryshme. Në tërësi, 10,438 fëmijë vijnë në shkollimin e rregullt në të gjitha nivelet.

Numri i institucioneve shkollore në komunën e Istogut: 5 kopshte të fëmijëve, 11 shkolla amë nëntëvjeçare, 15 paralele të ndara për shkollim fillor, 2 shkolla të mesme të larta dhe një paralele e ndarë e SHMT-profesionale “Rudina”, B. i Dubravës. Është vlerësimi i përgjithshëm se në aspektin organizativ, arsimi i komunës së Istogut është mirë i organizuar dhe i mbikëqyrur.

Rinia dhe sporti

Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit në komunën e Istogut funksionon edhe sektori për kulturë, rini dhe sport, i cili kryen një varg aktivitete në organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive.

Istogu ka një Shtëpi të Kulturës, një Qendër Kulturore e tri biblioteka, ku qytetarët e Istogut i organizojnë një sërë aktivitete kulturore. Sa i përket sportit, në Istog janë 5 klube sportive, dy qendra rinore, dy objekte për aktivitete rinore në zonat komunale dhe një objekt sportiv.

Me gjithë përparimin e bërë në infrastrukturë ende duhet bërë në ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe në avancimin dhe pajisjen e shkollave me teknologji informatike, salla të sportit etj.

Kultura dhe trashëgimia kulturore

Territori i komunës së Istogut ka trashëgimi të pasur kulturore, materiale dhe shpirtërore. Ky territor i përket krahinës etnografike të Podgurit, i cili ka qenë i banuar që nga parahistoria. Dëshmi për këtë janë disa varreza tumulare dardane, qytete dhe rrugë antike, si dhe materiali i konsiderueshëm arkeologjik i gjetur. Gjurmët e para të banimit të kësaj treve, të gjetura deri sot, i takojnë kohës së neolitit të vonë (mijëvjeçari i VI p.e.s.- sëpata e strallit e gjetur në Rakosh).

Edhe pse stacionet shpellore nuk janë hulumtuar, duket se edhe shpellat e shumta të Kosovës kanë qenë stacione banimi gjatë kohës së paleolitit dhe mezolitit (zbulime të tilla priten të bëhen me hulumtimin e shpellave). Kërkimet në këtë drejtim mendohet se do të jenë të favorshme, duke u mbështetur te numri i madh i vendbanimeve të epokës vijuese dhe të një kulture mjaft të begatshme të saj. Interesimi i parë për qendrat arkeologjike filloi në shekullin XIX, ndërsa studiuesi i parë që realizoi një ekspeditë arkeologjike gjatë Luftës së Parë Botërore ishte Budaj Arpad. Gjatë viteve '60-të dhe '70-të, me vendime të posaçme, janë futur nën mbrojtje 14 monumente kulturore. Në periudhën gusht-shtator 2000, është bërë një hulumtim i gjendjes së 49 kullave në komunën e Istogut, të udhëhequra nga Sahar Rassam (arkitekt) - zyrtar për çështje të banimit në Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Gjatë vitit 2002, është bërë inventarizimi i trashëgimisë kulturore të paluajtshme në komunën e Istogut, nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Gjakovë, ku janë evidentuar gjithsej 116 monumente të kulturës, prej të cilave lokalitete arkeologjike (9), kisha ortodokse mesjetare (4), xhami (8), mejtepe (3), kulla (72), ura (1), mulli (13), sharrë me ujë (1), kosha dhe hambar (5).

Në prill të vitit 2005, Instituti Arkeologjik i Kosovës, në bashkëpunim me sektorin e Muzeut dhe Arkeologjisë të komunës së Istogut, realizoi ekspeditën e evidentimit të vendgjetjeve arkeologjike në territorin e komunës së Istogut. Gjatë kësaj ekspedite u evidentuan rreth 30 vendgjetje arkeologjike, të cilat kanë një shtrirje kohore nga neoliti i vonë e deri në mesjetë. Gjykuar nga materiali arkeologjik, del se Podguri, si pjesë integrale e Dardanisë antike, ishte i banuar shumë herët.

8. Shëndeti publik dhe mirëqenia sociale

Komuna e Istogut është e përkushtuar për krijimin e kushteve për shërbime shëndetësore cilësore dhe sigurim të mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e tyre. Në komunë e Istogut kryhen shërbime primare dhe sekondare mjekësore. Këto shërbime qyte tarët e komunës së Istogut i kryejnë në pesë (5) qendra të mjekësisë familjare dhe në dhjetë (10) ambulanca në fshatra. Kurse, për shërbimet sekondare banorët e Istogut e shfrytëzojnë Spitalin Rajonal në Pejë dhe ambulancat private. Në qytetin e Istogut funksionon QKMF, kurse në fshatrat Vrellë, Banjë, Gjurakoc, Rakosh funksionojnë QMF-të. Shërbimet mjekësore, banorët e komunës së Istogut i kryejnë edhe në ambulancat e fshatrave, në: Kaliqan, Sudenicë, Dobrushë, Staradran, Zallq, Dubravë, Cërkolez, Shushicë, Veriq dhe Osojan.

Në QKMF janë këto shërbime: Shërbimi i Emergjencës, Shërbimi i Mjekësisë Familjare, Shërbimi i Internistikës, Shërbimi i Vaksinimit, Shërbimi i Maternitetit, Shërbimi i Stomatologjisë, Shërbimi i Pediatrisë, Shërbimi i Rëntgenologjisë, Shërbimi i Laboratorit.

Në QMF kryhen shërbimet e mjekësisë familjare dhe shërbimet stomatologjike, ndërsa në ambulanca vetëm shërbimet e mjekësisë familjare. Struktura e të punësuarve sipas profesionit në shëndetësi është: Mjekë (26), Teknik/e medicinale (63), Stafi administrativ (8), Stafi ndihmës-teknik (26). Gjithsej në mjekësi janë të punësuar 123 punëtorë. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet shëndetësore, 35 punëtorë janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 88 janë të gjinisë femërore.

Shumë nga drejtoritë e komunës së Istogut ofrojnë shërbime për t'i mbështetur përmirësimet në shëndetësi dhe mirëqenie të qytetarëve tanë dhe kjo do të vazhdojë të mbetet prioritet. Ato do të donin, në veçanti, të ofronin shërbime të reja për të rinjtë, për t'i inkurajuar ata që të jenë pjesë e një mënyre më të shëndetshme të jetesës dhe të bëhen pjesëtarë aktivë dhe pozitivë të komunitetit.

Prandaj, synimi kryesor i komunës është të krijohet një ambient ku njerëzit jetojnë më gjatë dhe kanë cilësi më të mirë të jetës, ku kanë qasje në kujdesin shëndetësor dhe e dinë që ne po punojmë për t'i përmirësuar shërbimet. Institucionet duan të promovojmë një cilësi më të lartë të jetës për qytetarët me probleme shëndetësore, për ta ngritur aftësinë e tyre për të kontribuar, si duke qenë të aftë për të punuar dhe për të gjithë qytetarët në përgjithësi, për shembull duke e promovuar sportin.

Për këtë qëllim kjo strategji parasheh programet kryesore dhe iniciativa si: ndërtimi i shtëpive për të pastrehët, përmirësimet në furnizimin me ujë, përmirësimet në MFM, shërbimet ambulante të përmirësuara, ndërtimi i fushave të sportit, kushte të përmirësuara kulturore (po ashtu promovohet turizmi).

9. Sistemi i menaxhimit të performancës dhe realizimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal

Procesi i krijimit të sistemit të menaxhimit të performancës komunale është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, i cili është menduar të bëhet sa më funksional në shërbim të komunës, në njërin anë, dhe, në anën tjetër, me interes për qytetarët e komunës së Istogut.

Sistemi i menaxhimit të performancës ka filluar të bëhet më efikas në vitin 2008, ku zyrtarët komunalë kanë zhvilluar takimin e parë me zyrtarët e lartë nga MAPL, dhe është rekomanduar që të fillohet me matje dhe vlerësime, të cilat janë në përgjegjësi të komunës. Pas kësaj janë krijuar grupet e ekspertëve, kryesisht të përbëra nga zyrtarët e komunës, të cilët ishin personat më adekuatë dhe përgjegjës për fusha specifike. Grupet e ekspertëve pastaj kanë përcaktuar rezultatet dhe kanë zhvilluar indikatorët për fusha të caktuara, të cilat më pastaj i kanë rekomanduar për Grupin Punues Kryesor (GPK). Pas kësaj kanë filluar trajnimet e përbashkëta të zyrtarëve të MAPL-së, zyrtarëve të komunave, përfaqësuesve të AKK-së dhe përfaqësuesve të ndërmarrjeve publike. Pas përfundimit të trajnimeve është dizajnuar një tabelë, e cila ka shërbyer për komunën që të raportojë të dhënat për indikatorët (treguesit) e fushave të përcaktuara. të cilat i janë dërguar MAPL-së, e cila në bazë të këtyre të dhënave ka hartuar raportin vjetor të performancës së secilës komunë.

Komuna më pastaj ka përzgjedhur zyrtarët e vet përgjegjës për të punuar në sistemin e menaxhimit të performancës dhe kanë punuar në bashkëpunim të ngushtë me MAPL-në dhe USAID EMI. Me qëllim që këta zyrtarë komunalë të jenë plotësisht të përgatitur për shfrytëzimin e këtij sistemi, MAPL dhe USAID EMI kanë mbajtur një seri punëtorish me zyrtarë, të cilat punëtorit kanë shërbyer për të sqaruar tërë sistemin e menaxhimit të performancës, rolin e këtij sistemi dhe metodologjinë e shfrytëzimit. Me përfundimin e këtyre punëtorive, zyrtarët janë certifikuar për të shfrytëzuar sistemin për menaxhimin e performancës. Gjatë vitit 2012 komuna në bashkëpunim të

ngushtë me programin DEMI të USAID-it dhe MAPL-në, kanë instaluar një link të veçantë në UEB faqen zyrtare të ministrisë, “Indikatorët e Shërbimeve Komunale”, i cili shërben për raportimin e të dhënave nga ana e komunës për sistemin e menaxhimit të performancës komunale. Ky nivel i avancuar i komunikimit me MAPL-në ka mundur edhe marrjen e mendimeve të qytetarëve për shërbimet të cilat i ofron komuna. Pra, në këtë link do t’u bëhet e mundur qytetarëve që të shohin të dhënat e komunës dhe të japin mendimin e tyre se sa janë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve. Përveç këtij linku, komuna ka edhe ueb-faqen e saj të veçantë e cila vazhdimisht freskohet me të dhëna. Angazhimi i vazhdueshëm i zyrtarëve të lartë komunalë, duke përfshirë kryetarin e komunës, drejtorin e administratës, për këtë sistem ka dhënë rezultate të duhura, të cilat kanë treguar për një menaxhim të mirë të procesit të vendosjes së sistemit të menaxhimit të performancës komunale në ofrimin e shërbimeve. Sistemi i menaxhimit të performancës komunale në ofrimin e shërbimeve përfshin 15 shërbimet komunale si: shërbimet administrative, mirëqenia sociale, kultura, rinia dhe sporti, emergjenca lokale, planifikimi urban, parqet dhe sheshet, rrugët, trotualet, transporti publik, parkingjet publike, ndriçimi publik, furnizimi me ujë, kanalizimi, grumbullimi i mbeturinave dhe deponimi i mbeturinave.

Mbledhja e të dhënave në komunë

Pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtari komunal, i/e cili/a është caktuar në cilësinë e koordinatorit/es për performancë të komunës, është i/e obliguar që të mbledhë të dhënat nga të gjitha drejtoritë e komunës, duke siguruar mbështetjen nga zyrtarët e certifikuar të performancës. Në kohën kur të dhënat grumbullohen nga ana e koordinatorit komunal, para se të fillojnë raportimin e tyre në MAPL, duhet të njoftohet drejtori i administratës, i cili duhet të njoftojë kryetarin e komunës lidhur me të dhënat e mbledhura për të gjitha shërbimet. Saktësia e të dhënave të mbled-

hura është e një rëndësie të madhe, sepse pasqyron gjendjen reale të komunës dhe për këtë arsye zyrtarët e lartë komunalë duhet të jenë në dijeni për këtë aktivitet në vazhdimësi.

Raportimi

Pjesa më e rëndësishme në tërë procesin e krijimit të sistemit të menaxhimit të performancës dhe në vazhdimësi të këtij procesi është raportimi i të dhënave nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara dhe saktësia e tyre paraqesin gjendjen reale të komunës. Kjo në të njëjtën kohë e bën të mundur hartimin e raportit

të rregullt për performancën e komunës, në të cilin prezantohen të dhënat për të gjitha shërbimet e përfshira në sistemin e performancës, për të gjithë indikatorët. Ky lloj i raportimit dhe hartimit të raporteve të rregullta mundëson që komuna dhe të gjithë akterët e procesit të shohin se si komuna ka avancuar shërbimet e saj nga viti në vit.

10. Vlerësimi i aftësive konkurruese të komunës së Istogut (SWOT analiza)

Tabela 10.1 pasqyron rezultatet e analizës SWOT, e cila identifikon pozicionin konkurrues të komunës së Istogut në raport me komunat e tjera të Kosovës dhe komunat e mëdha në regjion.

Kjo analizë ka shërbyer si bazë për identifikimin e synimeve dhe objektivave për të jetësuar vizionin e Istogut.

FAKTORËT	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Emri i burimeve <ul style="list-style-type: none"> • Planet hapësinore funksionale • Resurset për zhvillimin e bujqësisë (toka bujqësore, uji dhe klima) • Resurset natyrore për zhvillimin e turizmit (uji – natyral, termal, bjeshkët dhe bukuritë natyrore, reliefi i përshtatshëm dhe lidhjet ndërkufitare) • Popullsia relativisht e moshës së re dhe e arsimuar • Numri i madh i të punësuarve në diasporë • Tradita në disa sektorë të biznesit (kultivimi i peshkut, pemëve, bimëve mjekuese dhe aromatike, blegtoria) • Rrjedha e lumit të Istogut përgjatë qytetit • Prezenca e disa institucioneve me rëndësi (Qendra e Sigurisë, FSK) • Hapësirë e mjaftueshme për zgjerim të qytetit dhe plane infrastrukturore (12 % e territorit të komunës pronë komunale) • Evidenca e rregulluar kadastrale 	Mundësitë <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, prodhimi dhe përpunimi i produkteve të tyre • Zhvillimi i turizmit shëndetësor (banjave shëruese, ujit termal) dhe turizmi malor • Resurset e ujit të pijshëm dhe atij mineral si dhe fabrikimi i tyre. Natyra, klima, uji termal dhe i pijshëm • Fuqia e re punëtore e kualifikuar dhe e lirë • Toka e punueshme kualitative (pjellore) • Mundësitë për bashkëpunim me komunat fqinje dhe ndërkufitare në fusha specifike (p.sh. Pej[n p[r promovim t] turizmit) • Mundësitë e shfrytëzimit të potencialit turistik dhe agroturizmit. • Fondet e bashkëpunimit me BE-në, bashkëpunimi ndërkufitar • Mundësia e diasporës për investime në biznes dhe fusha të tjera
	NEGATIVË	Dobësitë <ul style="list-style-type: none"> • Komuna shtrihet larg arterieve kryesore të rrugëve nacionale të Kosovës • Niveli i ulët i trashëguar i zhvillimit ekonomik • Infrastruktura e pamjaftueshme për aktivitete kulturore dhe sportive • Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme për përpunimin e produkteve bujqësore • Zvogëlimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve bujqësore dhe dëmtimi i pyjeve • Zhvillimi i pamjaftueshëm i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në turizmin rural • Buxheti i pamjaftueshëm për projekte të mëdha kapitale • Mungesa e hekurudhës, • Niveli i pamjaftueshëm i turizmit kulturor, rural, kongresist, sportiv

Tabela 10.1: Vlerësimi i aftësive konkurruese të komunës së Istogut - Analiza SWOT

10. Vizioni, Misioni dhe Vlerat

Vizioni

Istogu, me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, infrastrukturë moderne dhe shërbime publike efikase dhe cilësore, i integruar në proceset rajonale, i gjelbëruar, i pastër, me pasuri natyrore dhe trashëgimi kulturore, qendër e turizmit, kulturës, sportit, arsimit dhe me shërbime shëndetësore cilësore.

Misioni:

Fuqizimi i aftësisë së komunës që, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive dhe të përgjegjshme për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë lokale.

Vlerat:

Ne kemi një grup të përbashkët të vlerave themelore, të cilat i japin formë mënyrës se si të merremi me klientët, partnerët dhe kolegët. Ne kërkojmë të sigurohemi se çdo gjë që bëjmë dhe shërbimet që i ofrojmë janë të drejta për personat që kanë nevojë për to, do të përpiqemi për:

Transparencë:

të jemi të hapur dhe të sqartë

Përgjegjshmëri:

të marrim përgjegjësi me vetëdëshirë dhe vendime të përgjegjshme

Drejtësi:

ne e vlerësojmë diversitetin dhe e promovojmë barazinë

Partneritet:

punojmë me qytetarë, biznese dhe partnerë të tjerë

Këto janë vlera kyçe me të cilat udhëhiqet komuna e Istogut drejt realizimit të misionit dhe jetësimit të vizionit të saj.

11. Synimet dhe objektivat

Vizioni i Komunës së Istogut është përcaktim i vullnetit dhe ambicieve të qytetarëve të Istogut për zhvillimin e komunës së tyre dhe krijimin e një ambienti tërheqës për të jetuar me mundësi për zhvillim të bujqësisë dhe turizmit dhe industrisë përpunuese. Krahas zhvillimeve para-prake, kjo Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Istogut do të paraqesë një kthesë kryesore dhe përqendrim në zbatimin e zhvillimit strategjik të komunës, për ta bërë atë tërheqëse për të jetuar dhe për të investuar.

Qeverisja komunale, së bashku me akterët kyçë, siç janë akterët e interesit në nivel lokal dhe qendror, duhet të përqendrohen që me prioritet t'i realizojnë synimet dhe objektivat e kësaj strategjie dhe të Planit Zhvillimor të komunës, që në mënyrë të dukshme i përbushin orientimet kryesore të vizionit të komunës. Në këtë drejtim, gjatë periudhës së kaluar strategjike, janë realizuar disa projekte të rëndësishme në përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës urbane dhe publike, ndërtimi i infrastrukturës rrugore, zgjerimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra dhe parqeve, infrastruktura rurale, mbështetja e bujqve për të zgjeruar aktivitetet e tyre.

